

Ebu Hamid El-Gazali

SHPËTIM NGA LAJTHITJA

Mitrovicě, mě
1417/1996

Titulli i origjinalit:

Ebu Hamid El-Gazali
EL-MUNKIZ MIN ED-DALAL

Përktheu nga boshnjakishtja:
Muhamed Ilijaz Dolaku

Lektor:
Mr. Mehdi Hyseni

Recensent:

Korrektore:
Ajshe Hyseni

Përpunimi kompjuterik:
Gëzim Dolaku

PARATHËNIE

"Shpëtim nga lajthitja" është me siguri vepra më e njohur dhe gjithsesi autobiografia shpirtërore më e rëndësishme në letërsinë islame.

Ebu Hamid Muhammed b. Muhammed b. Muhammed El-Gazaliu është përfaqësuesi më i shquar i shkencave islame dhe bartës i titujve më të ndershëm në botën islame, titullit garantues të Islamit dhe përtëritës i religjionit islam. Titullin e parë ai e ndanë me disa dinjitozë të mendimit dhe praktikës islame, e sipas titullit të dytë i takon zinxhirit të personaliteteve në veprat dhe veprimtaritë e të cilëve, sipas frymës së hadithit të Muhammedit alejhiselam, në mënyrë vitale caktohet shekulli apo epoka e egzistencës më të lartë të Islamit.

Gazaliu jetoi në pjesën e dytë të shekullit të pestë dhe në vitet e para të shekullit të gjashtë islam (450/1058-505/1111). Si shpirt i thellë religjioz që ishte, frymë jashtëzakonisht kureshtare dhe e pavarur, mendimtar burimor dhe sistematik, shkencëtar i gjithanshëm dhe i disiplinuar, Gazaliu që nga mesi i dekadës së katërt të jetës së tij, si shkrimtar dhe si profesor i Universitetit të famshëm Nizamije të Bagdadit, fiton famën e shkencëtarit fetar avangard të asaj kohe. Veprat të cilat i shkroi në vitet më të vonshme, veçanërisht "Ringjallja e shkencave fetare", ia kanë rritur famën dhe e kanë zgjeruar diapazonin e ndikimit shpirtëror të tij, kështu që emri i Gazaliut me kohë është identifikuar me apogjetë e

shkencave religjioze të Islamit, duke i bërë ato edhe sot më të afërta dhe më të përcaktuara.

Imam Gazaliu i dha kotribut të madh e origjinal jurispodencës, teologjisë, filozofisë dhe tesavvufit islam. Në çdonjërin nga këto lëmenj veprat e Gazaliut paraqesin përmbajtje të gjallë të çdo arsimimi më të lartë islam. Mirëpo, pozitë të veçantë në historinë shpirtërore të Islamit, Gazaliu e zë në rend të parë me atë që këto shkenca ose trajta të arsimimit shpirtëror të mësimit dhe të praktikës islame, i ka nënshtruar shqyrtimit fundamental, kritikës dhe vrojtimit reciprok nga pikëpamja e pajtueshmërisë së brendshme të së vërtetës së shpallur të ligjit fetar, zbulimit mistik dhe konceptit racional. Përpyekja e tij që ta bënë "drejtëbesimin mistik, misticizmin drejtëbesim, e të dyja filozofike", është gjë që nuk ka ndodhur më parë në Islam dhe me siguri është tejet vështirë të gjendet shembull përkatës në ndonjë tjetër shpirtërore.

Imam Gazaliu është njëkohësisht edhe njëri nga figurat e arsimimit klasik të Islamit veprat e të cilëve, me fuqinë e shprehjes të gjithëmbarshme shpirtërore, për një kohë të shkurtër i kanë kaluar kufijtë religjioze dhe kulturore të veçantisë islame. Mendimi i tij është i thurur në mendimin e shekullit të mesëm dhe atij të ri, në teologjinë dhe filozofinë bebreje, në lëvizjet shpirtërore të cilat kanë mugulluar në trevat e hindustanit gjatë ndeshjes me mësimin islam dhe traditës religjioze-filozofike hinduse. Është i njohur dhe i çmuar ndikimi i veprave të Gazaliut në Masses Majmonidesin, Tom Akvinskin, Mjeshttrin Ekhart, kurse në kohët më të reja gjithnjë e më tepër shquhet, në bazë të zbulimeve të pajtueshmërisë së thellë,

mundësia se ai ka ndikuar edhe në Descartesin, Leibnizin, Kantin. Nga ana tjetër, vërehet afria e premisave kryesore të Gazaliut me mendimin bashkëkohor.

Gazali gjithashtu është edhe mësues i madh i bujarisë. Veprat e veta ai i ka përmbushur me pasuri morale të jetës së vet, e jeta e tij në të cilën sikur të ishte reflektuar bota islame të kohës së tij në të gjitha vlerat dhe aspiratat vitale fetare, intelektuale dhe morale, pengesave dhe mundësive, ka qenë egzistencë konkrete personale e rrojtjes dhe e të vërtetës islame. Atë që ka bërë don të thotë lartësim metafizik që ndikon me fuqi të sinqeritetit të pastër, konsekuente dhe të denjë të njerëzimit të sotëm. Njohësit e jetës dhe veprave të Gazaliut, të vjetrit dhe bashkëkohorët, myslimanë dhe jomyslimanë, pajtohen me atë se ai është njëri ndër figurat më fisnike që ia ka dhënë bota islame vargut të gjenive të vërtetë të mbarë njerëzimit.

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

**Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

I lavdëruar qoftë Zoti, me lavdërimin e të Cilit fillon çdo shqyrtim dhe çdo kuvendim, qoftë i bekuar Muhammedi, i zgjedhuri, njeriu me ferrëfim dhe pejgamberizëm, të afërmit e tij dhe shokët e tij, të cilët largojnë nga lajthitja.

Kërkove prej meje, o vëlla për nga feja, që t'i zbulojë qëllimet dhe fshehtësitë e shkencave, rreziqet dhe ambiset e shkollave të mendimeve, dhe të të rrëfej gjithë çka kam përjetuar duke nxjerrë të vërtetën nga rrëmuja e sekteve të lloj-llojshme, mënyra e veprimit dhe rrugët e të calve janë kundërshtuar, dhe çfarë vendosmërie kam treguar duke u ngritur nga ultësira e imitimit në fe gjer tek lartësira e kërkimit të shpjegimeve. Kërkove që t'i parashtroj, nën një, çfarë dobie kam nxjerrë nga shkenca e kelamit, nën dy, se si i urrejta rrugët e talimijeve, të cilët, në pasimin e imamit, janë të paaftë ta kuptojnë të vërtetën, nën tre, se si i kam përbuzur rrugët e filozofimeve, dhe së fundi, se si i jam afruar rrugës së tesavvufit. Do të doja ta zbuloja edhe esencën e së vërtetës, e cila më është shfaqur gjatë hulumtimeve të mia të diturive njerëzore, ajo që më kishte shpëtuar nga veprimtaria e ime mësimdhënëse në Bagdad, ku kam pasur shumë nxënës, pastaj cili ishte shkaku që përsëri të kthehem në Nishapur, pas një kohe mjaft

të gjatë. Nxitova t'i jap satisfaksion kërkesës sate, pasi që e vërejta sinqeritetin e dëshirës sate. Duke kërkuar ndihmë nga Zoti, duke u mbështetur në Të, duke u lutur që të më udhëzojë dhe duke kërkuar strehim tek Ai, them:

Dije se - Zoti i Lartmadhërishëm të udhëzoftë në rrugën e drejtë dhe ta haptë zemrën për të vërtetën! - divergjencat e njerëzve në religjione dhe në besime, pastaj divergjenca e një bashkësie fetare në shkolla të mendimeve, me një mori sektesh dhe rrugësh të përkundërta, është det i thellë në të cilin shumica janë përmbytur dhe nga i cili pak sish kanë shpëtuar. Çdo grupacion mendon se mu ai ka shpëtuar, ***"secili grup i entuziazmuar me atë çka predikonte"***, dhe kjo është ajo që na ka premtuar më i zgjedhur ndër Pejgamberët, - Zoti e bekoftë! - i sinqerti, premtimet e të cilit plotësohen, kur ka thënë: *"Bashkësia (ummeti) ime do të ndahet në shtatëdhjetë e tre sekte, e vetëm njëri prej tyre do të jetë i shpëtuar."* E, tanimë ka ndodhur ajo që ka premtuar se do të ndodhë.

Që nga rinia më e hershme dhe nga koha më e bukur e jetës, që kur iu pata afruar pjekurisë dhe para se ti mbushja të njëzetat e gjer më tani, e i kam mbushur të pesëdhjetat, gjithnjë jam hudhur trimërisht në ambiset e atij deti të thellë, kam shkelur në ujën e tij të thellë vendosmërisht, e jo si ndonjë qyqar apo si ndonjë njeri i kujdesshëm. Thellohesha në të gjitha vendet e paqarta, sulesha në të gjitha pyetjet e vështira, trimërisht i ekspozohesha të gjitha rreziqeve, i hulumtoja besimet e të gjitha sekteve, i zbuloja

mendimet e fshehura të çdo grupacioni, në mënyrë që ta ndajë të vërtetën nga gënjeshtria, traditën burimore nga novacionet heretike.

Nuk e lëshoja kurrnjë batinije, e të mos dëshiroja të njoftohesha me ezoterizmin e tij, as ndonjë zahirije, e të mos nxitoja të kuptoj esencën e egzoterizmit të tij, as ndonjë filozof, e të mos detyrohesha të hyja në thelbin e filozofisë së tij, as ndonjë mutekelim, e mos të angazhohesha të udhëzohem në dialektikat dhe shqyrtimet e tij, as ndonjë sufist e të mos gjakoja të zbuloj sekretin e misticizmit të tij, as ndonjë shprestar e të mos tentosha të sodisja se si është duke ndikuar në të devocioni i tij, as heretikun i cili refuzon Cilësitë e Zotit, e mos të vështroja fshehurazi prapavinë e besimit të tillë, në mënyrë që t'i diktoja shkaqet e mohimit të turpshëm të tij të Cilësive të Zotit dhe shkaqet e herezisë së tij.

Etja për të kuptuar thelbin e gjërave ishte cilësi e imja dhe zakoni i imi që nga fillimi, që nga rinia më e hershme. Ishte ky instinkt pa zgjidhjen dhe pa përsiatjen time, gjithnjë gjersa në mua nuk u dobësuan shtrëngesat e imitimit në fe dhe nuk u thyen besimet e trashëguara, atëherë kur iu afrova kohës rinore. Sepse, e shihja se fëmijët e të krishterë rriteshin kurdoherë në krishterim, fëmijët hebrenjë rriteshin vetëm në judaizëm, e fëmijët myslimanë në islamizëm. E kam dëgjuar një traditë mbi Pejgamberin e Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - në të cilën thuhet: *"Secili që lind, lind i tillë çfarë e ka krijuar Zoti, e prindërit e bëjnë atë hebrej, ose të krishter, ose mazdej."*

Qenia ime e brendshme u dha në hulumtim të esencës të së vërtetës burimore nga Zoti dhe esencës së besimit të modifikuar

duke i imituar prindërit dhe mësuesit, dhe në hulumtimin e dallimeve mes besimeve të lindura nga imitimi. Parimet e tyre janë nxitëse (stimuluese), ndërsa në dallimin e të vërtetës nga gënjeshtra tek ata ekzistojnë mospajtime. Dhe i thash vetes:

"Së pari, caku im është të fitoj dijeni mbi esencën e gjërave. Domosdo, pra duhet ta hulumtoj esencën e gjërave! E ç'është ajo?"

Mu bë e qartë se është e saktë vetëm ajo dijeni në të cilën zbulohet njohuria duke mos lënë kurrfarë dyshimi, dhe krahas së cilës nuk ekziston mundësia e njimtimit dhe e gabimeve. E diç të tillë intelektin ynë nuk është në gjendje të arrijë. Sepse, siguria nga gabimet duhet të jetë e krahasueshme me vërtetësinë dhe t'i reziston argumentimit të përgënjeshtërimit, kështu që, sikur dikush ta shndërronte gurin në ari e shkopin në gjarpër, kjo megjithatë nuk do të shkaktonte as dyshim as mohim. Kështu, unë e di se dhjetë është më shumë se tre, e nëse dikush më thotë: "Jo, tre është më shumë se dhjetë, e si argument është ajo se këtë shkop do ta shndërroj në gjarpër", dhe para syve të mi ai me të vërtetë e bënë këtë, megjithatë, për shkak të kësaj nuk do të dyshoj në atë që e di; nga kjo do të rezultonte vetëm ajo se do të mrekullohesha me një fuqi të tillë, por assesi nuk do të dyshoja në atë që e di.

Pastaj, vërejta se çdo gjë që nuk e di në këtë mënyrë, dhe në çka nuk jam i sigurt me atë lloj vërtetësie, është dijeni e luhatshme dhe e pasigurt, e kurrnjë dijeni e pasigurt nuk është dijeni e vërtetë.

TË ZHYTURIT NË SKEPTICIZËM DHE MOHIMI I DIJENISË

Pastaj rishqyrtova dijeninë time dhe konstatova se, duke mënjanuar dhuntitë ndijore, jam i privuar nga dijenitë me veçori të tilla. Andaj thash në vete:

"Tani, pasi që u zhgënjeva, kam dëshirë t'i hulumtoj vetëm dijenitë e qarta. E këto janë dhuntitë ndijore dhe domosdoshmëritë e arsyes (mendjes). Andaj është e paevitueshme, që së pari të arrijë vërtetësinë e besimit tim në dhuntitë ndijore dhe vërtetësinë e sigurisë nga lajthitja në domosdoshmëritë e arsyes; a janë ato sikurse siguritë e mia të mëhershme të përfituara me imitim dhe nga siguria e shumicës së njerëzve në konceptimet mendore, apo kjo është siguri e padyshimt, në të cilën nuk ka mashtrim e as rrezik?"

Iu rreka me plotë seriozitet vëzhgimit të dhuntive ndijore dhe të domosdoshmërive të arsyes, për të parë se a ekziston mundësia që edhe vetë unë të dyshoj në to. Një analizë e gjatë e dyshimit më shpiu gjer aty që më nuk mund të besoja në besnikërinë e dhuntive ndijore. Dyshimi në to më kaploi dhe sikur thoshte:

"Prej nga ky besim në dhuntitë ndijore? Shqisa më e fuqishme është shqisa e të pamurit dhe kur të drejtohet kah hija, ajo sheh se hija qëndron në një vend dhe nuk lëvizë, andaj nxjerrë përfundim se aty nuk ka lëvizje. Pastaj, me anë të eksperiencës dhe soditjes, një orë më vonë, kupton se hija lëvizë, por ajo nuk lëvizë përnjëherit dhe aty për aty, por suksesivisht dhe pak nga pak, kështu

që kurrë nuk është në gjendje të palëvizshme. Ajo shikon yllin në qiell dhe e sheh se ai është i vogël, jo më i madh se moneta, ndërsa argumentet gjeometrike flasin se ai është më i madh se Toka."

Në këtë rast dhe në raste të ngjashme të perceptimeve shqisore, shqisa si gjykatëse sjellë gjykimin e vet, mirëpo gjykatësi arsyeja e rrëzon atë dhe tregon sheshit pavërtetësinë e gjykimit shqisor, i cili assesi nuk mund të mbrohet. Thash:

"U shkatërrua besimi im edhe në dhuntitë ndijore. Ndoshta është e mundur t'u besohet dhuntive të arsyes, të cilat janë parim i parë, sikurse deklarata e jonë se dhjetë është më shumë se tre, ose që një gjësendi në të njëjtën kohë nuk mund t'i përshkruhet dhe t'i mohohet diçka, ose që një gjësend i njëjtë nuk mund të jetë i krijuar dhe i pakrijuar, të ekzistojë dhe të mos ekzistojë, i domosdoshëm dhe i pamundshëm."

Por, shqisat përgjigjen:

"Përse je i sigurt se besimi yt në dhuntitë e arsyes nuk është i njëjtë sikurse ai në dhuntitë ndijore; sepse, neve na pate besuar, por erdhi gjykatësi arsyeja dhe na përgënjeshtrojë. Po të mos ishte gjykatësi arsyeja ti edhe më do të na konsideroshe si të vërteta. E, ndoshta mbrapa gjykatësit arsye ekziston ndonjë gjykatës tjetër i cili, po të paraqitej, do të tregonte sheshit mosvërtetësinë e gjykimit të arsyes, siç u paraqit gjykatësi arsyeja e tregoi sheshit tregoi mosvërtetësinë e gjykimit të shqisave. Fakti se një vërojteje e tillë nuk është duke u paraqitur, nuk do të thotë se ajo është e pamundur."

Pak ngurroja me përgjigje, andaj dhuntitë ndijore i rritën vështirësitë duke u thirrur në ëndrra.

"A nuk po e sheh", thanë ato, "se si në ëndërr u beson disa gjërave dhe i imagjinon disa rrethana, beson se ato janë konstante dhe permanente dhe nuk dyshon në to përderisa je në gjendje të tillë? Pastaj zgjohesh dhe kupton se e tërë ajo që ke imagjinuar dhe që ke besuar nuk ka bazë e as vlerë. E, përse je i sigurtë se e tërë ajo që beson në gjendje të zgjuar, në bazë të shqisava apo arsyes, është e vërtetë në raport me gjendjen në të cilën gjendesh? A nuk është e mundur që të të godasë një gjendje e cila do të jetë në raport me gjendjen e zgjuarsisë sate sikurse gjendja jote e zgjuarsisë në raport me gjendjen e ëndërrimit tënd, e gjendja jote e zgjuarsisë të jetë sikurse ëndërr? Nëse arrinë në gjendje të tillë, do të vërtetohesh se të gjitha ato që i ka konstatuar arsyeja e jote, në realitet janë vetëm imagjinata të zbrazëta."

Ndoshta kjo gjendje është vdekja, sepse Pejgamberi i Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - ka thënë:

"Njerëzit janë duke fjetur, e kur vdesin - zgjohen!"

Dhe ndoshta jeta e kësaj bote është ëndërr në raport me jetën e asaj bote. E, kur njeriu vdes, gjërat i paraqiten ndryshe nga ajo çfarë i sheh tani, dhe i thuhet në atë çast:

"Ta kemi ngritur perden (e syve), dhe shikimi yt sot është i mprehtë."

Pasi që më erdhën kësi mendimesh dhe u ngulitën në mua, u përpoqa që kësaj t'i gjejë ilaç. Mirëpo kjo nuk ishte lehtë, sepse mendimet e tilla i largon vetëm argumenti, e argumenti nuk është i

mundur të shtrohet për pa iu rrekur diturive të para. Pasi që kjo nuk është e lejuar, atëherë as që është e mundur të sjellet argumenti.

Kjo sëmundje e cila më mundonte shumë, zgjati afro dy muaj, gjatë të cilave isha skeptik, dhe atë duke gjykuar sipas gjendjes sime të brendshme, e jo sipas bisedës apo shprehjes, përderisa Zoti i Lartmadhërishëm nuk më shërojë nga kjo sëmundje, e mu kthye shëndeti dhe barazpesha shpirtërore. Domosdoshmëritë e arsyes përsëri u bënë të pranueshme dhe besova se janë të sigurta dhe të njëmendta.

Kjo nuk ndodhi për shkak të parashtrimit të argumentit apo diskutimit të arsyeshëm, por duke i falënderuar dritës, të cilën Zoti i Lartmadhërishëm e futi në shpirtin tim. Kjo dritë është çelës i shumë konceptimeve. Ai i cili konsideron se zbulimi prehet në argumentet e shkruara, ai e kufizon mëshirën e pakufishme të Zotit të Lartmadhërishëm.

Kur e kanë pyetur Pejgamberin e Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - përkitazi me shprehjen "të hapurit" dhe domethënien e saj në fjalët e Zotit të Lartmadhërishëm: ***"Atë që don Allahu ta udhëzojë ia hap zemrën e tij për islamizëm"***, ka thënë: *"Ajo është dritë, të cilën Zoti i Lartmadhërishëm e futë në zemër."* E çka është shenjë e saj?", kanë pyetur pastaj. Ai është përgjigjur: *"Të kthyerit nga vendbanimi i kotësisë dhe të drejtuarit kah vendbanimi i përjetësisë."* Përkitazi me këtë Muhammedi - paqja e Zotit qoftë mbi të! - ka thënë: *"Zoti i Lartmadhërishëm i ka krijuar krijesat në errësirë, pastaj i ka stërmbushur me dritën e Vet."* Nga kjo dritë duhet kërkuar të zbuluarit, e duke qenë se kjo

dritë rrezaton nga burimi i gjithëmëshirës së Zotit në disa çaste, atë dritë duhet përgjuar - siç ka thënë Muhammedi - Zoti e bekoftë! - : *"Në disa periudha të kohës tuaj, Zoti i juaj ka derdhje dashamirësie; e ju ekspozohuni asaj!"*

Domethënia e këtyre të thënave është se gjurmimi duhet të realizohet gjatë përsosmërisë së plotë, derisa nuk na shpie gjer tek gjurmimi i asaj që nuk ka nevojë të gjurmohet. Parimet e para nuk ka nevojë të gjurmohen. E ajo që është e pranishme, kur të kërkohet, ikë dhe zhduket. Ai i cili gjurmon atë që nuk duhet gjurmuar, nuk mund të akuzohet për paaftësi në gjurmim të asaj që gjurmohet.

LLOJET E GJURMUESVE

Pasi që Zoti i Lartmadhërishëm me mëshirën e Vet dhe me mbushullimin e fisnikërisë së Vet më shëroi nga kjo sëmundje, para syve të mi llojet e gjurmuesve u reduktuan në katër grupe:

1. mutekelimët, të cilët e kanë shpallur veten si njerëz të mendimit dhe të spekulimit;

2. batinijët, të cilët deklarojnë se janë pasues të mësimin mbi doktrinën dhe se dallohen duke përfitur dijeni nga imamët e pagabueshëm;

3. filozofët, të cilët e kanë shpallur veten si njerëz të logjikës dhe të argumentimit;

4. sufistët, të cilët konsiderojnë se vetëm ata janë të aftë për praninë e drejtpërdrejtë, për të parë dhe për të zbuluar.

Dhe i thash vetes:

"E vërteta nuk shtëmang prej këtyre katër lloj gjurmuesish. Ata kanë pasuar rrugën e kërkimit të së vërtetës, e nëse e vërteta nuk do të ishte në mesin e tyre, atëherë nuk do të kishte shpresë se ajo do të mund të konceptohet ndonjëherë. Sepse, nuk ka shpresë në kthim në imitim të fesë pasi që tani më ajo është ngadhënjyer, pos me kusht që imituesi i imamit nuk e di se është imitues. E kur ta kupton këtë, atëherë thyhet ena e qelqtë e imitimit të tij. Ajo thyhet copa-copa dhe nuk mund të mblidhet më, thërrmohet e nuk mund të bashkohet as me harrnim as me ngjitje, pos që thërrmijat të shkrihen në zjarrë dhe nga ato të formohet një prodhim i ri.

Nxitova ta ndjekë këtë rrugë dhe të hulumtoj thellësisht atë që kanë arritur këto katër grupe, duke filluar së pari nga mutekelimët, pastaj me rrugën e filozofëve, pastaj me doktrinën e batinijeve dhe në fund me rrugën e sufijëve.

SHKENCA E KELAMIT: CAKU DHE TË ARRITURAT E SAJ

Atëherë fillova me shkencën e kelamit. E mësova atë dhe e kuptoja mjaft mirë; i vëzhgoja shkresat e themeluesve të saj, dhe edhe vetë shkruajta për të atë që dëshiroja të shkruaj.

Dhe gjeta se ajo është shkencë e cila e kënaq qëllimin e vet.

Qëllimi i saj është ta ruajë besimin e ithtarëve të Sunnetit dhe t'i mbrojë ata nga trazirat e futësve të risive.

Atyre të cilët i shërbejnë Atij, Zoti i Lartmadhëruar u ka dhënë besim të vërtetë përmes gojës së Pejgamberit të Vet; tek Ai

gjendet e mira e jetës religjioze dhe profane e tyre, siç është thënë për të konceptuarit e Tij në Kur'an dhe në Hadith. Pastaj djalli ka sjellur, me inkoherencën e autorëve të risive, gjëra në kundërshtim me Sunnetin. Duke i preferuar ato, autorët e risive gati sa nuk i patën ngatërruar ithtarët e besimit të vërtetë.

Atëherë Zoti i Lartmadhërishëm bëri që të paraqiten mutekelimët, duke i nxitur ata, që me diskutime të rregulluar ta mbrojnë Sunnetin dhe t'i demaskojnë ithtarët e risive në kundërshtimin e tyre të traditës pejgamberike. Në këtë është lindur shkenca e kelamit dhe në këtë janë rritur dijetarët e saj.

Dhe, me të vërtetë, një grup mutekelimësh në mënyrë të zellshme e përmbushën detyrën e tyre, në të cilën i pat udhëzuar Zoti i Lartmadhërishëm; me sukses e ruajtën Sunnetin, e mbrojtën besimin e pranuar nga pejgamberizmi dhe i demaskuan risitë e paraqitura.

Por, në këtë u orientuan sipas premisave të marrura nga kundërshtarët e tyre, të cilat detyronin të rrëzoheshin ato premisa duke u thirrur qoftë në imitimin në fe qoftë në mendimin e harmonizuar të bashkësisë së besimtarëve ose madje edhe në disa rrëfime nga Kur'an dhe Hadithi. Diskutimi i mutekelimëve kështu kryesisht rraskapitej në zbulimin e kontradiktave tek kundërshtarët dhe në kritika për shkak të pranimit të tyre. Në këtë ka shumë pak dobi për atë që pranon vetëm parimin e dhuntisë së domosdoshme.

Prandaj shkenca e kelamit nuk mundi ta kënaqë nevojën time për të vërtetën e as ta shërojë sëmundjen, nga e cila ankohesha.

Vërtet, kur u zhvillua shkathësia e kelamit dhe kur shqyrtimet u bënë të shumënumërta, pas një kohe të gjatë, mutekelimët shprehën dëshirë të madhe që të përpiqen ta mbrojnë Sunnetin duke gjurmuar për thelbin e gjërave; ndërmorën hulumtime më të thella të esencës, të dukurive dhe të dispozitave të tyre. Por, duke qenë se kjo nuk ishte qëllimi i shkencës së tyre, ajo që patën thënë përkitazi me këtë, nuk e arriti cakun e fundit, e as që zbulimi i tyre t'i ketë shpërndarë në tërësi errësirat e hutueshmërisë në mesin e njerëzve.

Nuk mohoj se kjo nuk është arritur tek të tjerët, e as që dyshoj në vlershmërinë e zbulimit të tyre për një grup njerëzish, por ky zbulim është në lidhshmëri me imitimin në gjërat të cilat nuk i takojnë parimeve të para. E unë tani kam ndërmend ta përshkruaj rastin tim, e jo t'i qortoj ata të cilët në shkencën e kalamit kërkojnë shërim. Ilaçet dallojnë prej sëmundjes në sëmundje; sa ka ilaçe që i ndihmojnë një të sëmuri e tjetrit i bëjnë dëm!

FILOZOFIA

Pasi që mbarova me shkencën e kelamit, kalova në shkencën e filozofisë.

Tanimë e disha me siguri se gabueshmërinë e ndonjë shkence mund ta shoh vetëm ai i cili i arrinë kufijtë e saj skajore dhe nivelizohet me dijetarët e saj më të mirë, i tejkalon ata dhe arrin shkallën në të cilën u bëhen të qarta ato thellësi dhe plasaritje në atë

shkencë, të cilat nuk i shfaqen përfaqësuesve të saj. Vetëm atëherë mund të jetë e vërtetë ajo që ai konfirmon për gabueshmërinë e asaj shkence. E, unë nuk kam parë kurrnjë dijetar islamik të ketë bërë përpjekje të shumta rreth filozofisë.

Në librat e mutkelimëve, në të cilët ata tentojnë t'i përgënjeshtrojnë filozofët, gjenden vetëm deklarata të pandërlidhura dhe të paharmonizuara, kështu që ato nuk mund ta mashtrojnë as njeriun me maturi të rëndomtë e le më njeriun të udhëzuar në hollësitë e shkencës. Kuptova se të rëzuarit e një doktrine, para se ajo të kuptohet dhe të studiohet gjer në fund, është gjuajtje me sy të mbyllur. Dhe bëra përpjekje maksimale që, vetëm duke lexuar dhe pa ndihmën e mësuesve, gjer në fund ta zotëroj shkencën e filozofisë.

Këtë e bëja në orët kur nuk isha i zënë me ligjërimet e shkencave juridike, e atëherë isha i ngarkuar me mësimin dhe aftësimin e rreth treqind studentëve në Bagdad. Dhe, dha Zoti - i Lavdëruari dhe i Lartësuari - që me vetë lexim gjatë atyre orëve të grabitura, për më pak se dy vjet, t'i zbuloj tërësisht të arriturat skajore të shkencës së filozofisë. Mirëpo, nuk u ndala me kaq, dhe, pasi që e kuptoja atë, vazhdova ta përsias edhe më se një vjet; përsëri iu kthehesha dhe i hulumtoja thellësitë dhe ambiset e saj, gjersa nuk mu sqarua në mënyrë ku nuk mund të dyshohet, se ç'është në filozofi fanitje dhe mashtrim, e vërtetë dhe e pavërtetë.

E, pra, dëgjoje ligjërimin mbi filozofinë dhe ligjërimin mbi koncizitetin e diturive të filozofëve.

Vërejta se ka shumë lloj filozofësh dhe se doktrinat e tyre janë të ndara. Megjithatë, ata, gjithë sa lloje ekzistojnë, duhet konsideruar përgjegjës (fajtor) për ceni të mosbesimit dhe të pafesë, edhe pse të vjetrit e më të vjetrit, të mëvonshmit e të mëhershmit, dallojnë shumë në mes veti në afrimin e vërtetësisë dhe në largimin nga ajo.

Llojet e filozofëve të cilët duhet të konsiderohen mosbesimtarë

Dije se filozofët, me gjithë morinë e sekteve të tyre dhe shkollave të ndryshme mendimesh, ndahen në tri grupe:

materialistët

natyralistët

metafizikanët

Lloji i parë - materialistët. Ata janë një nga grupet më të vjetra. Ata mohojnë Krijuesin, të Gjithëdiqshmin dhe Udhëheqësin e Gjithëfuqishëm, pandehin se Bota, e tillë çfarë edhe është, ekziston pandërprerë vetvetiu dhe pa Krijuesin, dhe se qeniet e gjalla lindin pandërprerë nga farët, e farët nga qeniet e gjalla - kështu ka qenë dhe kështu do të jetë për jetë të jetëve. Ata janë pabesimtarë.

Lloji i dytë - natyralistët. Ata e kanë hulumtuar shumë botën natyrore dhe mrekullitë e mbretërisë bimore dhe shtazore, e

posaçërisht kanë përparuar në shkencën mbi konstruksionin e organeve të shtazëve. Në këtë ata shohin mrekullitë e krijimtarisë dhe frytet e mençurisë të Zotit të Lartmadhërishëm, që i ka detyruar ta pranojnë Krijuesin e Urtë, të udhëzuar në esencën dhe cakun e gjërave. Tek e mbramja, nuk është e mundshme të zbulohet përbërja dhe përshtatshmëria e mrekullueshme në efikasitetin e organeve, e të mos vihet tek dituria e domosdoshme mbi dispozicionin e mrekullueshëm që u ka dhënë Krijuesi kompozimeve trupore të shtazëve, e posaçërisht të njeriut.

Megjithëkëtë, për shkak të hulumtimeve të shumta të botës natyrore, ndër natyralistët është përhapur besimi se proporcionaliteti i veçorive trupore ndikon fuqishëm në organizimin e aftësive të qenieve të gjalla. Ata konsideronin se edhe aftësia e njeriut njësoj mvaret nga veçoritë e tij trupore dhe se lind e shkatërrohet me zhdukjen e veçorive trupore. E, pandehin se nuk mund të paramendohet kthimi i diçkaje që nuk ekziston më. Dhe kanë ardhur gjer aty që të konfirmojnë se shpirti vdes e nuk kthehet kurrë më.

I bien hasha botës tjetër dhe e kontestojnë parajsën dhe zjarrin e skëterrës, ringjalljen dhe shpalljen, gjykimin dhe dhënien e llogarive, kështu që, sipas mendimit të tyre, nuk ekzistojnë shpërblimet për veprat e mira e as ndëshkimet për mëkate. I kanë humbur frerët, dhe kështu sikurse kafsha, janë zhytur në pasione.

Edhe këta, gjithashtu, janë pabesimtarë, sepse baza e fesë është të besohet në Zotin dhe në Dita e gjykimit, e ata, edhe pse e besojnë Zotin dhe cilësitë e Tij, e mohojnë Ditën e gjykimit.

Lloji i tretë - metafizikanët. Ata, sikurse Sokrati, nxënësi i tij Platoni dhe nxënësi i Platonit Aristoteli, janë paraqitur më të fundit në mesin e filozofëve.

Aristoteli për ta e ka mbarështuar logjikën, i ka klasifikuar shkencat, ka shkruar atë që nuk ka qenë e shkruar, e ka sjellur gjer tek pjekuria atë që në shkencat e tyre nuk ka qenë e pjekur. Dhe të gjithë ata i kanë kundërshtuar dy llojet e para të filozofëve, materialistët dhe natyralistët, duke i zbuluar të metat e tyre kështu që të tjerët nuk kanë pasur nevojë ta bëjnë këtë. *"E Allahu i kursei besimtarët nga lufta"*, nga përleshja me ta.

Aristoteli, pastaj, aq pamëshirshëm i ka përgënjeshtuar Platonin, Sokratin dhe metafizikanët të cilët i kanë paraprirë, sa që ka hequr dorë prej të gjithë atyre, edhe pse edhe vetë nuk ishte liruar nga cenia e mosbesimit të tyre dhe risive të tjera. Prandaj duhet të konsiderohen pabesimtarë edhe ata edhe vazhduesit e tyre nga mesi i filozofëve myslimanë, siç janë ibën Sina, Farabi dhe të ngjashëm me ta. Sepse, për transmetimin e doktrinës së Aristotelit nuk është meritë kurrnjë filozof muslimanë sikurse që janë këta dy njerëz. Ajo që kanë transmetuar të tjerët nuk është e privuar nga çrregullimi dhe tollovia, në të cilat turbullohet intelekti i lexuesit, kështu që ai nuk mund ta kuptojë këtë. E si të kundërshtohet apo të pranohet diç që nuk mund të kuptohet. E tërë ajo burimore që kemi nga filozofia e Aristotelit, e që e kanë transmetuar këta dy njerëz, mund të reduktohet në tri pjesë:

1. pjesa për shkak të cilës ajo domosdo duhet të konsiderohet mosbesimtare,

2. pjesa për shkak të cilës ajo domosdo duhet të konsiderohet risi në fe, dhe

3. pjesa për shkak të cilës ajo nuk është e domosdoshme që parimisht të kundërshtohet, e këtë do ta shqyrtojmë.

Ndarja e shkencave filozofike

Dije se shkencat e tyre, duke pasur parasysh qëllimin që pretendojmë ne, ndahen në gjashtë grupe: shkenca matematikore, logjike, natyrore, metafizike, politike dhe etike.

1. matematika ngërthen aritmetikën, gjeometrinë dhe astronominë, dhe me asgjë nuk ndërlidhet me gjërat e religjionit, qoftë për t'i kundërshtuar, qoftë për t'i afirmuar ato. Kjo është shkencë për gjërat të argumentueshme, të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të mohohen, pasi që të konceptohen dhe të pranohen një herë nga ana e arsyes.

Megjithatë, nga kjo kanosen dy rreziqe.

Rreziku i parë është se ai që hynë në brendinë e saj, ai mrekullohet me saktësinë e saj dhe me njëmendësinë e argumenteve të saj, e për këtë shkak përfiton mendim të mirë mbi filozofinë dhe mendon se të gjitha shkencat filozofike sipas qartësisë dhe fuqisë së argumenteve janë sikurse matematika. Pastaj dëgjon se filozofët nuk besojnë, se i mohojnë cilësitë e Zotit dhe i refuzojnë ligjet e Zotit, dhe, duke i ndjekur këta, edhe vet fillon të

mos besojë, duke thënë: "Po qe se religjioni do të ishte e vërteta, atëherë kjo nuk do t'u ikte njerëzve, të cilët zotërojnë me dituri të sakta çfarë janë në këtë shkencë!" Dhe kur nga bisedimet njoftohet me refuzimin dhe kundërshtimin e tyre të religjionit, konkludon se ky refuzim dhe kundërshtim i religjionit është e vërteta. Sa e sa herë kam parë njerëz që për shkak të kësaj, dhe pa kurrfarë shkakut tjetër, ka bredhur nga e vërteta!

Njeriut të tillë mund t'i thuhet: "Dikush që është i udhëzuar në ndonjë shkathtësi nuk do të thotë se është i udhëzuar në çdo shkathtësi. Nuk është e domosdoshme që dijetari i shkencës juridike dhe shkencës së kelamit të jetë njësoj i shkathtë edhe në shërimin e sëmundjeve, e as që paudhëzimi në shkencat mendore domosdo do të thotë edhe paudhëzim në gramatikë. Në çdo dituri ekzistojnë njerëz të cilët në të kanë arritur shkallën e lartë të përsosmërisë dhe të zellit e që të mos jenë liruar marrëzisë në fusha të tjera. Shqyrtimet e të Vjetërve janë bazuar në matematikë me argumente, ndërsa në metafizikë me supozime, dhe këtë mund ta kuptojë vetëm ai që është sprovuar në këtë dhe që është thelluar në këtë."

Mirëpo, kur kështu i thuhet njeriu, i cili ka lejuar të jetë i mashtruar me imitim të verbët, ai këtë nuk do ta pranojë, por ende do të ketë mendim të mirë për të gjitha shkencat filozofike, sepse atë e udhëheqë dëshira tejet e madhe, trimëria e zbrazët dhe prirja që të bëhet i mençur. Ky është rreziku i madh dhe është nevoja që t'i tërhiqet vërejtja për këtë çdonjërit që lëshohet në këto shkenca. Edhe pse ato nuk janë në lidhje me gjërat religjioze, për shkak të

parimeve të tyre njeriu lehtë mund të bjerë në kob dhe në mynxyrë, dhe pak kujt që është lëshuar në këto shkenca i ka shkuar për dore të mos largohet nga religjioni dhe që nga koka të mos i bien frerët e devotshmërisë.

Rreziku i dytë vie nga njeriu i sinqertë në Islam, por injorant. Ai mendon se religjionin duhet ndihmuar me kundërshtimin e çdo shkence e cila ka prejardhje nga filozofia, andaj i kundërshton të gjitha shkencat e saj ndërsa shkencëtarët e saj i shpallë injorantë. Ai në këtë mënyrë kundërshton edhe shpjegimin e tyre të zënies së Diellit dhe të Hënës, duke konsideruar se krejt ajo që thonë ata është në kundërshti me ligjin fetar. E kur për këtë dëgjon dikush që të zënët e ka konceptuar në bazë të argumentit të qartë, ai nuk do të dyshojë në argumentin e vet, por do të besojë se Islami është i bazuar në mosdije dhe në kundërshtimin e argumenteve pakontestuese, e prej këtui do të zmadhon dashurinë e vet ndaj filozofisë dhe urrejtjen ndaj Islamit. Me të vërtetë, ai i cili mendon se Islami ndihmohet duke kundërshtuar shkencën matematikore, bënë krim të madh ndaj religjionit.

Pejgamberi i Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të!
- ka thënë: *"Dielli dhe Hënë janë me të vërtetë dy shenja nga shenjat e Zotit të Lartmadhërishëm, dhe nuk zihen (errësohen) për shkak të vdekjes apo lindjes së dikujt. E kur ta shihni këtë, kërkoni mbështetje në të përmendurit e Zotit të Lartmadhërishëm dhe në namaz."*

Në këto fjalë nuk ka mohim të matematikës, me ndihmën e së cilës në mënyrë të posaçme kuptohen orbita e Diellit dhe e Hënës, konjuksioni i tyre dhe opozicioni i tyre. Për sa i përket fjalëve të Pejgamberit të Zotit - qoftë i bekuar! -: "*Kur Zoti i shfaqet diçkaje, ajo i nënshtrohet Atij!*", kjo është shtesë, e cila nuk gjendet në traditat burimore.

Ky është gjykimi mbi shkencën matematikore dhe rreziqet e saj.

2. *Shkencat logjike*, përsa i përket këtyre, në to gjithashtu asgjë nuk është në lidhje me religjionin, qoftë mohuese, qoftë afirmative. Ato janë përsiatje mbi mënyrat e argumentimeve dhe vlerësimeve, mbi kushtet e premisave të argumentimit dhe kualitetit të përpilimit të tyre, mbi kushtet e përcaktorëve të vyeshëm dhe kualitetin e prejardhjes së tyre. Dituria paraqitet qoftë si nocion, atëherë rruga e përfitimit të saj është përcaktori, qoftë si gjykim, e atëherë rruga e përfitimit të saj është argumenti. Këtu nuk ka asgjë që do të duhej të kundërshtohet. Përkundrazi, me këtë gjatë argumentimit janë shërbyer edhe mutekelimët dhe përfaqësuesit e mendimeve spekulative, prej të cilëve logjicistët dallojnë me cytjet dhe nocionet teknike, dhe me intenzitetin e hulumtimeve dhe klasifikimeve.

Shembulli për doktrinën e logjicistëve është deklarata e tyre: "Kur të argumentohet se çdo **A** është **B**, domosdo pason se ndonjë **B** është **A**", ose: "Kur të argumentohet se çdo njeri është qenie e gjallë, domosdo rezulton se disa qenie të gjalla janë njerëz". Ata e

shprehin këtë edhe duke thënë se deklarata universalo-afirmative kthehet në deklaratën partikularo-afirmative.

E ku është këtu lidhmëria e tyre dhe e gjërave të rëndësishme të fesë, për t'u refuzuar dhe kundërshtuar logjika? Nëse kundërshtohet, prej këtu rezulton mendimi i keq i logjicistëve, jo vetëm për mendjen e atij që kundërshton logjikën, por edhe për religjionin e tij, sepse refuzuesi pandeh se religjioni mbështetet në këtë kundërshtim.

Vërtet, në shkencën e tyre logjicentët nuk janë të liruar nga lajthitja e veçantë. Ata për argumentim ndërlidhin konditat për të cilat dihet se pa përjashtim shpiejnë gjer tek dituria e besueshme. Por, kur më në fund arrijnë tek caqet e religjionit, tregojnë tolerancë tejet të madhe dhe nuk ua mundësojnë që vlerën e vet t'a argumentojnë me ndihmën e këtyre konditave.

Ngandonjëherë mbi logjikën përsiat edhe ndokush që e njeh mirë atë dhe e sheh qartësinë e saj dhe, duke menduar se premiset e mosbesimtarëve prehen në argumente të njëjta, ngarend me mosbesim edhe para se të ketë arritur gjer tek shkencat metafizike.

Ky rrezik gjithashtu shpie në mosbesim.

3. *Shkencat natyrore*, studiojnë botën e qiellin, yjet që janë në qiell dhe trupërat që gjenden nën të, ata të thjeshtë - siç janë uji, ajri, toka dhe zjarri, dhe ata të ndërlikuar - siç janë shtazët, bimët dhe mineralet, dhe ndërrimet, transformimet e përzierjet e tyre. Kjo i përngjet studimit mjekësor të trupit të njeriut, organet kryesore dhe ndihmëse të tij, dhe shkaqet e ndërrimit të langjeve të tij. Dhe,

sikurse kondita e religjionit nuk është të kundërshtuarit e mjekësisë, kondita e tij nuk është as kundërshtimi i shkencës natyrore, pos në dis çështje të caktuara, të cilat i kemi prezentuar në librin *"Inkoherenca e filozofëve"* , që në këtë shkencë duhet të kundërshtohen. Gjatë shqyrtimit më të afërt, na bëhet e qartë se të gjitha të tjerat reduktohen në të.

Baza e këtyre kundërshtimeve është se ata doktrinojnë se natyra është e nënshtruar Zotit të Lartmadhërishëm; se ajo nuk është vetëvepruese dhe se i kryen veprimet e Krijuesit të vet. Edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe elementet natyrore janë të nënshtruar urdhërit të Tij. Asnjëri prej tyre nuk vepron nga vetvetiu dhe prej vetvetiu.

4. *Shkencave metafizike* për sa i përket, në këto qëndrojnë lajthitjet kryesore të filozofëve. Ata nuk janë në gjendje t'i plotësojnë konditat për dëshmi të cilat i vënë vetë në logjikë, andaj në shkencat metafizike ekzistojnë shumë mospajtime mendimesh në mes tyre.

Doktrina e Aristotelit, siç e kanë transmetuar Farabi dhe ibën Sini, është më e afërt doktrinës islame.

Megjithatë, e tërë ajo në çka gabojnë ata mund të reduktohet në njëzet premisa. Tri prej tyre janë të atilla për shkak të cilave metafizikanët duhet të konsiderohen mosbesimtarë, e për shkak shtatëmbëdhjetë të tjerave - futës të risive.

Në mënyrë që t'i përgënjeshtroi doktrinat e tyre në këto njëzet pyetje, kam shkruar librin *"Inkoherenca e filozofëve"*. Për sa i

përket tri premisave me të cilat ata i kundërvihen të gjithë myslimanëve, ja se çka thonë ata:

a). *Trupërat nuk ringjallen*; shpërblimi dhe ndëshkimi i takojnë shpirttrave; shpërblimi dhe ndëshkimi është shpirtëror, e jo trupor.

Duke konfirmuar shpirtëroren, ata gjithsesi e flasin të vërtetën, sepse shpirtërorja gjithashtu është ekzistente, mirëpo gënjejnë duke mohuar truporen, dhe me këtë deklaratë kundërshtojnë ligjin fetar.

b). Ata thonë: "Zoti i Lartmadhërishëm i di nocionet e përgjithshme, e nuk i di gjërat parciais."

Ky është mosbesim i hapët, sepse është e vërtetë se ***"Diturisë së Tij nuk mund t'i shmanget as sa një thërrmi, as në qiell as në Tokë."***

c). Ata thonë se *Bota është e pafillimtë dhe e pambarimtë*, e kjo është premisë të cilën nuk e pason kurrnjë mysliman.

Përsa i përket gjërave të tjerë: mohimit të tyre të cilësive të Zotit dhe konfirmimit të tyre se Zot di sipas qenies e jo sipas dijenisë që i është dhënë qenies, dhe ngjashëm me këtë, doktrina e tyre është e afërt me atë të mu'etezilëve, e mu'etezilët për këtë shkak nuk duhet të konsiderohen mosbesimtarë.

Në librin *"Peshoja për dallimin e Islamit dhe herezisë"* kam sqaruar pasaktësinë e mendimit të atij, i cili menjëherë e shpallë si herezi tërë atë që nuk është në pajtim me doktrinën e tij.

5. *Shkencave politike* për sa i përket, i tërë diskutimi i filozofëve këtu reduktohet në rregulla të vyeshme për gjërat profane (të kësaj bote) dhe pushtetit të mirë, e edhe ata i marrin këto nga Librat e Zotit të shpallura Pejgamberëve dhe nga sjelljet e trashëguara nga Pejgamberët e mëhershëm.

6. *Shkencave etike* për sa i përket, diskutimet e filozofëve këtu në tërësi reduktohen në lidhshmërinë e cilësive në karakterin e shpirtit, numërimin e gjinive dhe të llojeve të tyre, si dhe mënyrën e edukimit dhe vetëpërmbytjes së tyre. Filozofët këtë e kanë marrë nga kuvendimet e sufistëve, njerëzve të devotshëm, të cilët qëndrueshmërisht e përmendin Zotin e Lartmadhërishëm, i kundërvihen pasioneve dhe ndjekin rrugën kah Zoti i Lartmadhërishëm, duke u përmbytur nga kënaqësitë e kësaj bote.

Në përpjekjet e tyre, sufistët e kanë zbuluar karakterin e shpirtit, të metat e tij dhe rreziqet tek të cilat mund të shpiejnë veprimet e tyre, dhe këtë e kanë publikuar, e filozofët këtë e kanë marrë dhe e kanë kyçur në diskutimet e veta, në mënyrë që me këtë zbulim t'i fshehin lajthitjet e veta personale dhe ta nxisin përhapjen e tyre.

Në kohën e tyre, si dhe në çdo kohë tjetër, kanë ekzistuar grupe njerëzish të devotshëm, pa të cilët Zoti - i lavdëruar qoftë Ai - nuk e lë Botën kurrë. Ata janë shtyllat e Tokës, siç transmetohet në traditën në të cilën Muhammedi - mëshira dhe paqja e Zotit qofshin mbi të - thotë: *"Për hir të tyre ju fitoni shiun; për hir të tyre ju fitoni furnizimin; e nga mesi i tyre kanë qenë Shokët e Shpellës."*

Sipas asaj që flitet në Kur'an për Shokët e Shpellës, ata kanë jetuar në kohët e mëhershme.

Filozofët në librat e tyre i kanë përfshirë fjalët e Pejgamberëve dhe të sufistëve, dhe nga ky mendim rrjedhin dy rreziqe:

- *rreziku për atë që pranon këtë,*
- *rreziku për atë që kundërshton këtë.*

Për sa i përket *rrezikut nga kundërshtimi*, ky është shumë i madh. Sepse, njerëzit me intelekt të dobët mendojnë se këto fjalë, pasi që janë shkruar në librat e filozofëve dhe janë përzier me mosvërtetësitë e tyre, duhet të injorohen dhe mos të përmenden, aq më tepër, se duhet gjykuar secilin që i citon ato. Duke qenë se për të parën herë këto fjalë i kanë dëgjuar nga filozofët, për shkak të dobësisë të intelektit të tyre kanë ardhur në përfundim se këto fjalë nuk janë të vërteta, sepse është gënjeshtar ai prej të cilit i kanë dëgjuar ato.

Kjo i shëmbëllen qëndrimin të njeriut, i cili ka dëgjuar deklaratën e një të krishteri: "Nuk ka zot tjetër pos Zotit; Isai është i Dërguari i Zotit!", e këtë e kundërshton duke thënë: "Kjo është deklaratë e të krishterit!" dhe nuk ndalet në atë se përse i krishteri për të është mosbesimtar: për shkak të kësaj deklarate apo për shkak të mohimit të pejgamberizmit të Muhammedit - Zoti e bekoftë! Nëse i krishteri është mosbesimtar vetëm për këtë mohim, nuk duhet t'i kundërvihet në atë që nuk është mosbesimtar, e që është e vërtetë nga vetvetiu pa marrë parasysh se a është e vërtetë edhe për të krishterin. Por, ky është zakoni i njerëzve me arsye të

dobët; ata e shquajnë të vërtetën sipas njerëzve, e jo njerëzit sipas të vërtetës.

Njeriu i arsyeshëm i ndjek fjalët e udhëheqësit në mesin e imamëve, Ali ibën Ebi Talibit - Zoti qoftë i kënaqur me të! - i cili ka thënë:

"Mos e shquaj të vërtetën sipas njerëzve, por shquaje të vërtetën e do t'i shquash ata të cilët i përkasin asaj."

Njeriu i arsyeshëm e koncepton të vërtetën, pastaj thellohet në esencën e ndonjë deklarate, e nëse është e vërtetë, e pranon atë duk mos marrë parasysh se a rrjedhë ajo nga gënjeshtari apo nga njeriu vërtetëdashës. Aq më tepër, ai përpiket ta gjenë të vërtetën edhe në deklaratat e njerëzve të lajthitur, duke e ditur se ari është i fshehur në dheun e rëndomtë.

Këmbyesi i të hollave, i cili është i sigurtë në aftësitë e veta për dallim, nuk do të jetë në dëm nëse e futë dorën në thesin e falsifikatorit, sepse ai do ta ndajë arin e pastër nga falsifikati dhe të hollat e rrejshme. Megjithatë, ai nuk ka guxim t'i këmben diçka as mashtruesit fshatar para se ta vërtetojë atë. Larg nga bregu i detit mbështetju njeriut që nuk di not, e jo atij që di not; fëmijës, e jo zbutësit të kafshëve, i ndalohet ta prekë gjarprin.

Pasha jetën time, nëse kjo është e mundur, duhet që në tërësi të pengohet leximi i librave të shkrimtarëve të lajthitur - për shkak se tek shumica e njerëzve mbizotëron mendimi për vetveten e tyre si personalitete me aftësi të larta, me eksperiencë të madhe, me arsye të përsosur në dallimin e të vërtetës nga gënjeshtria, rrugës së drejtë nga rruga e lajthitjes. E ata, madje edhe nëse janë të sigurtë

nga rreziket për të cilat folëm më lartë, nuk mund t'i ikin rrezikut, të cilin do ta parashtrojmë tani.

Një grup njerëzish pa mbështetje të fortë në fshehtësitë e diturive, njerëzish të cënuar (privuar) nga caqet skajore të mësimi, më kanë qortuar për shkak të disa deklaratave në veprat e mia, në të cilat kam shkruar mbi fshehtësitë e shkencave të religjionit, duke pandehur se ato deklarata i kam marrë prej të Vjetërve, edhe pse disa prej tyre janë mendime të mia burimore - e nuk është e pamundur që një thundër të shkel në gjurmën e thundrës tjetër - të tjerat gjenden në veprat e ligjeve fetare, e shumica sipas domethënies rrjedhin nga librat e sufistëve.

Të lejojmë, megjithatë, që këto deklarata të gjenden vetëm në veprat e filozofëve të vjetër. Nëse ato janë të kuptueshme vetvetisht, nëse janë të provuara me argumente dhe nëse nuk janë në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin, atëherë përse duhet të refuzohen dhe të kontestohen."

Po që se ia hapim derën kësaj dhe refuzojmë çdo të vërtetë të cilën e prezenton para nesh njeriu të cilin nuk e trajtojmë (respektojmë), atëherë duhet të refuzojmë shumë çka të vërtetë. Kështu do të detyroheshim t'i refuzonim disa ajete kur'anore dhe tradita të Pejgamberit të Zotit, rrëfimet e të parëve dhe të thënat e dijetarëve dhe sufistëve, sepse shkrimtari i *"Mesazh miqve Besnik"* i citon në veprën e vet, në mënyrë që me to të konfirmojë mosvërtetësinë e vet dhe të ndihmojë ta pranojnë zemrat e njerëzve të pakuptueshëm. E kjo do sillte atë që njerëzit e lajthitur ta marrin

të vërtetën nga duart tona dhe të disponojnë të drejtën në të në shkresat e tyre.

Më së paku që mund të kërkohet nga njeriu i dijshtëm është që ai të dallon nga injoranti, dhe që të mos i gërditet mjalti, madje edhe nëse gjendet në enën e mbledhësit të gjakut, sepse ai e din mirë se kjo enë nuk e ndërron cilësinë e mjaltit. Të gërditurit e zakonshëm shpjegohet me mosdijen e njeriut i cili është i mashtruar me atë se ena është e prodhuar për mbledhjen e gjakut të papastër, andaj mendon se gjaku është i papastër sipas enës, e nuk e di se papastërtia është cilësi e vetë gjakut. Pasi që mjalti nuk e ka atë cilësi, as që do ta përfitojë edhe nëse gjendet në atë enë, andaj nuk duhet ta konsiderojmë të papastër.

Kjo është lajthitje e marrë, por kjo mbretëron tek shumë njerëz. Çfarëdo deklarate të sjellësh, po qe se ia përshkruan njeriut për të cilin njerëzit kanë mendim të mirë, ata do ta pranojnë atë madje edhe nëse nuk është e vërtetë, e nëse ia përshkruan personit të cilin e marrin për të keq, do ta mohojnë edhe nëse ajo është e vërtetë. Ata gjithnjë e shquajnë të vërtetën sipas njeriut, e jo njeriun sipas të vërtetës.

Ja, këtu qëndron rreziku i kundërshtimit.

Rreziku nga pranimi:

Nëse dikush e soditë ndonjë libër të filozofëve, siç është "*Mesazh Miqve besnik*" etj., dhe sheh se në to janë vendosur mençuritë e lajmëtarëve të fesë dhe fjalët e sufistëve, ndoshta do t'i miratojë ato, do t'i pranojë dhe do t'u besojë atyre, dhe ngarend që t'i pranojë lajthitjet të cilat janë të përziera me ato (mençuri), e tërë

këtë e bënë për shkak të mendimit të mirë i cili ka rezultuar nga ajo që ka parë dhe që ka miratuar. E kjo tanimë është zhytje suksesive në lajthitje.

Për tu siguruar nga ky rrezik është e domosdoshme të pengohet të lexohen librat e tyre, sepse ato përmbajnë pabesi dhe falsitete. Siç është nevoja që njeriu që nuk di not të mbahet larg brigjeve të rrëshqitshme, po ashtu është nevoja të mbrohen njerëzit nga leximi i këtyre librave. Dhe siç është nevoja që fëmija të mbahet larg gjarprit, po ashtu duhet që njerëzit të mbrohen nga dëgjimi i këtyre diskutimeve tepër të ngatërruara.

Njeriu i dijshtëm duhet të jetë porsi zbutësi i shkathët atëherë kur ky vetë e merr gjarprin. Zbutësi e ndanë kundërhelmin nga helmi, e nxjerrë kundërhelmin dhe e shkatërron helmin. As njeriu i dijshtëm nuk duhet t'ia shkagon (ndalë) kundërhelmin atij që i duhet ky. Ai duhet të jetë edhe porsi këmbyesi mendjehollë i parave kur e futë dorën në thesin e falsifikatorit. Këmbyesi nxjerrë prej aty arin e pastër dhe i mënjanon falsitetet dhe paratë e rrejshme, dhe nuk duhet të koprracaojë duke u dhënë atyre që i duhen.

Njeriut të cilit i duhet kundërhelmi i gjarprit, e ndaj tij ndien gërdi pasi që është nxjerrur nga gjarpri i cili sekron (kullon) helm, është nevoja t'i sqarohet kjo.

Varfanjakut të cilit domosdo i nevojiten të hollat e kundërshton t'i merr ato sepse vien nga thesi i falsifikatorit, është nevoja t'i shpjegohet se refuzimi i tij është pasojë e mosdijes së kulluar dhe shkak që po mbetet pa dobinë të cilën po e kërkon. Në fund duhet t'i shpjegohet se edhe afërsia më e madhe ndërmjet të

hollave origjinale dhe të falsifikuara nuk mund t'i shndërroi ato origjinalet në falsifikat, sikurse që nuk mund ta bëjë të pavërtetë të vërtetë e as të vërtetën të pavërtetë.

Ja, kaq deshta të them përkitazi me rrezikun dhe kobin të cilat vijnë nga filozofia.

DOKTRINA E TALIMIJËVE DHE DËMI I TYRE

Pasi që mbarova me shkencën e filozofisë, me studimin e saj, të kuptuarit e saj dhe pasi që dallova se çka është në të e rrejshme, kuptova se as ajo nuk plotëson në tërësi atë që premtun dhe se mendja nuk është në gjendje t'i përfshijë të gjitha pyetjet dhe t'i zgjidhë të gjitha enigmat.

Atëherë u paraqitën talimijet më të spikatur dhe përhapën në mesin e njerëzve përrallën për konceptimin e gjërave të cilat i jep imami i pagabueshëm dhe i qëndrueshëm në të vërtetën. Dhe vendosa t'i gjurmoj të thënat e tyre në mënyrë që të ndriçohet se çka përmbajnë shkrimet e tyre.

Ndërkohë ndodhi që nga kalifi të më vijë urdhëri i prerë që ta shkruaj një vepër me të cilën do të zbulohej se çka është në të vërtetë doktrina e tyre. Kësaj nuk mund t'i ikja; cytja nga jashtë iu shtua shtytjes sime të brendshme dhe fillova t'i studiojë shkrimet e tyre dhe t'i mbledh të thënat e tyre.

Tanimë më kishin arritur disa të thëna të talimive. Ato rezultonin nga përfaqësuesit bashkëkohor të doktrinës mbi të

mësuarit nga imamët e pagabueshëm dhe nuk i ishin besnik rrugës të cilën e përfaqësonin themeluesit e saj. I mbledha ato të thëna, rivendosa mes tyre renditje të fortë, i nënshtrova verifikimit me krahasime - dhe më në fund dhash përgjigje të plotë në to. Atëbotë dis njerëz nga rruga e të vërtetës më qortuan se e kam tepruar duke i përforcuar argumentet e talimijeve. Ata thoshin:

"Ke punuar për ta! Ata kurrë nuk do të mundnin t'i ndihmonin vetvetes para paqartësisë së doktrinës së tyre, sikur të mos e verifikoshe dhe rregullosh ti."

Ky protestim nuk është i pabazë.

Kur Ahmed ibën Hambeli e kishte qortuar Haris Muhasibiun - Zoti i mëshiroftë që të dy - për shkak të shkrimit të tij kundër mu'etezilëve, e Harisi i kishte thënë: "Përgënjeshtrimi i risive është obligimi më i rreptë i fesë!", Ahmedi ishte përgjigjur: "Gjithsesi! Por ti më së pari e ke parashtruar lajthitjen e tyre, e pastaj je përgjigjur në të. Si mund të jesh i sigurt se nuk do të paraqitet dyshimi tek ai, i cili këtë e merr me mirëkuptim, e nuk përqëndrohet në përgjigjen tënde, ose mendohet për përgjigjen tënde, por nuk arrinë që ta kuptojë atë në esencë?"

Qortimi i ibën Hanbelit është i arsyeshëm, por - kur ka të bëjë me lajthitjen e cila nuk është e përhapur. Atëherë, përgjigja në të është e domosdoshme, e kjo është e mundur vetëm atëherë kur ajo parashtrohet.

Nuk është nevoja që dikush tjetër ta përpunojë lajthitjen e talimijeve të cilën vetë ata nuk e kanë parashtruar. Unë këtë nuk e kam bërë vetë. Përkundrazi, këtë lajthitje e kam dëgjuar prej një

miku, i cili ishte ndarë prej meje pasi që u ishte bashkuar atyre dhe kishte filluar ta favorizonte doktrinën e tyre. Thoshte se talimijet janë duke i përqeshur shkrimtarët e veprave në të cilat refuzohen mësimet e tyre, sepse këta shkrimtarë asgjë nuk kuptonin nga argumentimet e tyre. Pastaj e parashtroj këtë argumentim ashtu siç e ekspozojnë ata. Nuk dëshiroja që ata të mendojnë për mua se edhe unë nuk e kam përfillur argumentimin e tyre burimor, andaj edhe e kam parashtruar atë, e që të mos mendojnë se kam dëgjuar por nuk kam kuptuar, e kam parashtruar në formën e tij origjinare. Qëllimi im ishte që ta prezentoj lajthitjen e tyre sa është e mundur, e pastaj në mënyrë të qartë të tregojë dëmin e saj. Prej këtui edhe rezulton se ata asgjë nuk ofrojnë dhe se polemizimet e tyre nuk kanë kurrfarë vlere.

Dhe me siguri se kjo risi, e dobët siç është, nuk do të përhapej gjer në atë shkallë pa ndihmën e njerëzve vërtetëdashës por injorantë. Prudencia (zelli) e zjarrtë e atyre që e përkrahin të vërtetën i ka shpjerrë ata në kontestim jetëgjatë me talimijet mbi supozimet e mësimet e tyre, dhe në përgënjeshttrim të të gjitha atyre çka flitnin ata; kundërshtonin edhe argumentin mbi mësimin dhe mësuesin, e talimijet doktrinojnë se nuk është mësim i vyeshëm i nxënë nga çfarëdo mësuesi, por vetëm nga mësuesi i pagabueshëm. E gjatë këtyre polemizimeve është publikuar argumentimi i talimijëve si dëshmi e qartë mbi mësimin dhe mësuesin, ndërsa të folurit e kundërshtarëve të tyre është treguar i dobët. Kjo i ka sjellur në lajthitje disa njerëz të cilët këtu shihnin fuqinë e mësimit të talimijëve dhe dobësinë në mësimin e atyre që i

përgënjeshtrojnë ata. Këta njerëz nuk vërenin se kjo është dobësi e mbrojtësve të së vërtetës dhe mosnjohja e tyre e rrugës e cila shpion kah e vërteta. Sepse, është e vërtetë se kemi nevojë për mësues, dhe atë për mësues të pagabueshëm. Por, mësuesi i ynë është Muhammedi - mëshira dhe paqja e Zotit qofshin mbi të!

Nëse talimijet thonë: " Ai është i vdekur", do të përgjigjemi: "Mësuesi i juaj është i fshehur."

Ata mund të thonë: "Mësuesi ynë i ka mësuar predikatorët dhe i ka dërguar nëpër vende, dhe ai e pret kthimin e tyre nëse në mes tyre paraqiten mosmarrëveshjet apo ballafaqohen me paqartësi." Ne do të përgjigjemi: "Mësuesi ynë gjithashtu i ka mësuar predikatorët dhe i ka dërguar nëpër vende. Mirëpo ai mësimin e ka mbaruar, siç ka thënë Zoti i Lartmadhërishëm: ***"...Sot ua përsosa dispozitat e fesë suaj dhe ua plotësova dhuntinë Time ndaj jush..."*** E prej momentit kur mësimi ka përfunduar, vdekja e mësuesit nuk shkakton dëm, sikur që nuk shkakton dëm as mosprezenca e tij."

Mbetet pyetja e tyre: "Si do të gjykoni mbi atë që nuk keni dëgjuar përpara? Sipas tekstit, për të cilin nuk keni dëgjuar, apo sipas komentimit të lirë, apo sipas mendimit tuaj personal, që është burim i mosmarrëveshjeve?" Do të përgjigjemi: "Do të veprojmë ashtu siç ka vepruar Muadhi, atëherë kur Pejgamberi i Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - e ka dërguar në Jemen. Do të gjykojmë sipas tekstit nëse gjendet në tekst, e nëse nuk gjendet, do të përpiqemi që gjer tek gjykimi të vijmë sipas komentimit të lirë. Pra, mu ashtu siç bëjnë predikatorët e tyre kur e

braktisin imamin e tyre dhe shkojnë në vendet e largëta dhe kur nuk janë në gjendje të gjykojnë sipas tekstit. Tekstet e kufizuara nuk mund të përfshijnë të gjitha rastet e panumërta, e për çdo rast parcial nuk është e mundur kthimi në qytet ku gjendet imami. Përveç kësaj, nuk është e pamundur që ai i cili e ka dërguar predikatorin të vdes para se ta kapërcejë atë largësi e të kthehet, dhe kështu të mos ketë kurrfarë dobie nga udhëtimi.

Nëse dikush dyshon për drejtimin e kthimit në namaz, i mbetet vetëm të mbështetet në gjykimin e lirë. Nëse ndërmerr udhëtim në ndonjë qytetin ku gjendet imami, për të kuptuar se kah duhet të kthehet, do ta humbas kohën e namazit. Andaj është e lejuar që njeriu në namaz të kthehet në drejtim kah nuk është Kibla, por është caktuar sipas gjykimit të lirë personal."

Është thënë: "Atij i cili gabon në gjykimin e vet personal i takon një shpërblim, ndërsa atij që ia qëllon i takojnë dy."

Të përmendim shembullin e domosdoshmërisë të dhënies së varfanjakut. Është e mundur që ai i cili jep, duke pasuar gjykimin e vet personal, konsideron se dikush është i varfër, e ky në realitet është pasanik i cili me kujdesë e fshehtë pasurinë e vet. Dhënësi nuk do të jetë i qortuar për shkak se ka gabuar, sepse nuk i shihet për të madhe ajo që është rezultat i gjykimit të lirë personal.

Nëse talimiu do të thoshte: "Mendimi i atij njeriu vlenë sa edhe mendimi i kundërshtarit të tij", ne themi: "Ai është i obligueshëm të pason mendimin e vet personal, ashtu siç është i obligueshëm edhe ai i cili gjykon për drejtimin e kthimit në namaz

të pason gjykimin e vet personal madje edhe nëse i kundërshton të tjerët."

Nëse thotë: "Imituesi e ndjek Ebu Hanifen ose Shafiun - Zoti i mëshiroftë që të dy! - madje edhe të tjerët", ne do të themi: "E si të veprojë imituesi i cili dyshon në drejtimin e kthimit në namaz, kur përkitazi me këtë nuk pajtohen as ata të cilët gjykojnë për të?" Në këtë ai mund të vërenë: "Imituesi atëherë ka të drejtë në gjykimin personal duke u mbështetur në dijenitë e njohësve më të mirë të shenjave për kthimin e drejtë në namaz; ai do të ndjekë gjykimin e vet personal, dhe kështu është me të gjitha mësimet."

Mbështetja e njerëzve në gjykimin personal është i detyrueshëm, sepse edhe Pejgamberët edhe imamët që kanë dijeni ngandonjëherë gabojnë. Pejgamberi i Zotit - Zoti e bekoftë! - ka thënë: *"Unë gjykoj sipas së dukshmës, e Zoti qeverisë me të padukshmën."* Që don të thotë, unë gjykoj sipas mendimit mbretërues të marrur nga dëshmitarët, e është e mundur që ata gabojnë. As Pejgamberët, pra, nuk kanë mënyrë që plotësisht të sigurohen nga gabimet në rastet kur kërkohen gjykime personale, e atëherë si mund ta dëshirojmë ne këtë!?

Talimijet atëherë mund t'i parashtrojnë dy pyetje.

E para: "Nëse gjykimi personal është i vyeshëm në të gjitha rastet të cilat kërkojnë gjykim, e nuk është i vyeshëm në rastet që kanë të bëjnë me bazat e besimit, sepse këtu gabimi nuk është i lejuar, si është procedimi për kesi rastesh?" Do të përgjigjemi: "Bazat e besimit janë të përmbajtura në Kur'an dhe në Sunnet. Ndërsa për paragrafet kontestuese të cilat mbeten, shquarjen e së

vërtetës e siguron peshimi i tyre me peshojën e drejtë. Ky është në realitet një kompleks i kriterëve që Zoti i Lartmadhërishëm i jep në Librin e Vet. Janë gjithsej pesë dhe i kam shpjeguar në veprën *"Kriteri i drejtë"*

Nëse thotë: "Kundërshtarët e tu nuk pajtohen me ty mbi atë kriter", do të them: "Nuk mund të paramendohet se dikush mund ta kuptojë këtë kriter e pastaj të ndahet në mendime rreth tij, dhe nuk është e mundur që me të të mos pajtohen talimijet, sepse e kam nxjerrë nga Kur'ani dhe Kur'ani më ka mësuar për të. Me të janë të obliguar të pajtohen edhe logjicistët, sepse i kënaq kushtet e mendimit logjik dhe nuk i kundërshtojnë ato, e edhe mutekelimët, sepse pajtohet me mësimin e tyre mbi argumentimin teorik me ndihmën e të cilit ata në polemizimet e tyre dialektike e shquajnë të vërtetën."

Nëse bënë vërejtje: "Nëse posedon kriter të përshtatshëm, përse atëherë nuk e mënjanon mospajtimin mes njerëzve?", do të them: "Sikur të më dëgjonin, do ta mënjanoja mospajtimin mes tyre. Në veprën *"Kriteri i drejtë"* kam parashtruar mënyrën e mbikalimit të mospajtimeve; përsiat për të dhe do ta kuptosh se është i vërtetë dhe se i zhdukë mospajtimet në tërësi atëherë kur i mbështetemi atij. Por, nuk iu kanë mbështetur të gjithë. Një grup më ka dëgjuar, dhe i kam zhdukur mospajtimet në mes tyre. Ndërkaq, imami yt dëshiron t'i ndërpresë mospajtimet mes tyre edhe pse ata nuk e dëgjojnë. Përse gjer më tani nuk ka pasur sukses në këtë? Përse nuk i ka zhdukur mospajtimet e Aliut - e bekoftë Zoti i Lartmadhërishëm! - e ai është i pari prej imamëve? A beson imami

yt se është i aftë t'i detyrojë njerëzit që ta dëgjojnë? Përse gjer me tani nuk i ka detyruar? Dhe gjer në cilën ditë e ka shtyer afatin e kësaj? Dhe përgjithësisht, a ka arritur diç me thirrjen e vet tek njerëzit pos rritjes së mospajtimeve dhe shumëzimin e kundërshtarëve? Me të vërtetë, duhet të frikësohemi nga mospajtimet të cilat shkaktojnë gjakderdhje, shkatërrimin e qyteteve, bonjakimin e fëmijëve, mbylljen e rrugëve, plaçkitjen e pasurive! E, duke i falënderuar "ndërprerjes së bekuar të mosmarrëveshjeve" tuaja, në botë ka ndodhur diçka e padëgjueshme gjer më tani."

Nëse talimiu thotë: "Pohon se i mënjanon mospajtimet ndërmjet njerëzve. Mirëpo, njeriu i cili hamendet në mes mësimave kontestuese dhe dallimeve të ballafaquara nuk është i obligueshëm që të dëgjojë ty më me andje se kundërshtarin tënd. Shumica e kundërshtarëve nuk pajtohet me ty, e nuk ka dallim mes teje dhe kundërshtarëve të tu." Kjo është pyetja e dytë e tyre.

Përgjigjem: "Kjo vërejtje para së gjithash kthehet kundër teje. Kur e thirrë tek ti njeriun i cili hamendet të pranojë aspektin tënd, ai do të të thotë: "Shumica e njerëzve të dijshtëm nuk pajtohen me ty!" Do të doja të dija se çfarë përgjigje do t'i jepshe! Nëse përgjigjesh: "Në imamin tim është treguar në tekst!", kush do të të besojë në bazë të tekstit të cilin nuk e ka dëgjuar nga Pejgamberi i Zotit!? Aq më tepër kur ai do ta dëgjojë thirrjen tënde në të njëjtën kohë kur edhe fjalët e dijetarëve të cilët thonë se ky është trillimi yt dhe gënjeshtria yte.

Të lejojmë se ai njeri i pavendosur pajtohet me ty rreth tekstit, por hamendet rreth themelit të pejgamberizmit, e thotë: "Lejoj që imami yt të përdorë mrekullinë e Isait gjatë argumentimit të vet, e të thotë: "Argument se e flasë të vërtetën është ai që do ta ngjalli babain tënd!", e pastaj e ngjallë dhe thotë se e ka plotësuar premtimin. Si ta di unë se ajo që flet ai është e vërtetë? Shumica e njerëzve në bazë mrekullisë së tillë nuk e kanë shquar se Isai - Zoti e mëshiroftë - e ka folur të vërtetën. Aq më tepër, kjo është një pyetje tejet e vështirë e cila mund të zgjidhet vetëm me spekulimin e hollësishëm mendor. E, për ty spekulimi mendor nuk është i besueshëm. Por të pranojë mrekullinë si argument të së vërtetës mundet vetëm ai njeri i cili e njehë magjinë dhe dallimin mes saj dhe mrekullibërjes pejgamberike, dhe i cili e di se Zoti në atë moment nuk është duke i mashtruar robët e Vet - e është e njohur mirë se sa vështirë është të gjendet përgjigjja përkritazi me shpirjen në lajthitje.! Si do ta zgjidhish ti tërë këtë? Imami yt nuk është në përparësi në raport me kundërshtarin e vet." Ai i kthehet argumentit spekulativ të cilin e ka mohuar dhe i cili e ofron kundërshtari i tij, por tani më qartë; kjo vërejtje, pra, kthehet kundër tyre aq fuqishëm sa që nuk do të mundnin të përgjigjen në të edhe sikur të tuboheshit që të gjithë, prej të parit gjer tek i fundi.

Turbullimi është zgjeruar duke i falënderuar atyre mistrecëve që i kanë udhëhequr diskutimet dhe kanë dhënë përgjigje, përderisa në intelektin e vet nuk i kanë mbizotëruar çështjet; kështu që diskutimi vetëm vazhdon e nuk nxitë mirëkuptimin dhe të heshturit e kundërshtarëve. E nëse thotë: "Por

kjo pikërisht është çështje e trazimit të shpirtit, e a ka përgjigje për këtë?", do ti them: "Po!" Përgjigjja është se njeriut të turbulluar i cili deklaron se është i hutuar e nuk e di se cila çështje e huton, thotë se ai është sikurse njeriu i sëmurë i cili thotë se është i sëmurë dhe kërkon ilaç për sëmundje, e nuk tregon se nga cila sëmundje në realitet rënkon. Të tillit do ti thuhet se nuk ekziston ilaç për sëmundje përgjithësisht, por vetëm për sëmundje të caktuar, siç është dhembja e kokës, vështirësitë në stomak etj. Njësoj edhe njeriu i turbulluar duhet të përcaktojë ç'është ajo që e huton; e kur ta bënë këtë, do ta njoftojë me të vërtetën në një nga pesë mënyrat, të cilat askush nuk i ka kuptuar e të mos i konceptojë se çdonjëra prej tyre është kriter i të vërtetës. Kush mbështetet në peshim do ta kuptojë kriterin dhe vërtetësinë e peshimit, sikur që studenti i matematikës njëkohësisht kupton edhe aritmetikën dhe njohjen e drejtë të mësuesit të aritmetikës. Këtë e kam parashtruar në veprën "*Kriteri i drejtë*" në afro njëzet faqe, e le ta shqyrtojë këtë!

Nuk kam për qëllim që tani të tregoj pështjellimin e doktrinës së tyre, sepse këtë e kam bërë kaherë:

1. në librin "*El-Mustazhiri*";
2. në librin "*Argumenti i të së vërtetës*", i cili ka njëzet kaptina dhe përgjigjet në atë që më ishte parashtruar në Hemedan;
3. në librin "*Dallimi i hollësishëm*", i cili i ka dymbëdhjetë kaptina dhe përgjigjet në atë që më ishte parashtruar në Hemedan;
4. në librin "*Ngritja*", në të cilën në formë tabelare janë treguar fjalët e tyre më së paku të kuptuara që mi kanë parashtruar në Tusi;

5. në librin "*Kriteri i drejtë*", i cili është i pavarur, e qëllimi i tij është të tregojë se si imami i pagabueshëm është panevojshëm për atë që e pason.

Qëllimi im është të tregojë se si talimijet assesi nuk posedoj ilaç për shërim nga errësira e pikëpamjeve të ndryshme. Ata nuk kan mundur ta mbajnë argumentin mbi përshtatshmërinë (qëllimin, arsyen) e imamit, atëherë kur i patëm pyetur mbi dituritë që i kanë mësuar nga imamët e pagabueshëm, pasi që ishim pajtuar me ta dhe kishim pranuar arsyen e tyre për të mësuar nga imami i pagabueshëm ashtu si e caktojnë ata. Ua patëm parashtruar disa pyetje të caktuara, por ata as që i kuptonin e le më t'i sqaronin ato. Të pafuqishëm ata këtë ia hudhën imamit të fshehur, duke thënë: "Gjithsesi është e domosdoshme të shkohet tek ai!" Është për tu habitur se si ata tërë jetën ia kushtojnë kërkimit të imamit dhe gëzimit të takimit me të, por prej tij nuk mësojnë asgjë. Ata i shëmbëllojnë njeriut të përlyer i cili aq shumë lodhet duke kërkuar ujë sa që kur e gjenë atë, nuk ka fuqi ta përdorë dhe mbetet i lyer me ndyrësi.

Disa prej tyre thirren në dituri e cila mund të gjendet në atë që e kam parashtruar si filozofi të cekët të njërit nga filozofët e vjetër - Pitagorës. Doktrina e tij është më e dobëta ndër doktrinat filozofike dhe Aristoteli e ka përgënjeshtuar atë, duke treguar sheshit dobësinë dhe përdheshmërinë e saj. Për të flitet ne "*Libri i miqve besnik*", dhe me të vërtetë kjo është një filozofi pa përmbajtje autentike. E, a nuk është vërtet e çuditshme që dikush tërë jetën të lodhet duke kërkuar dituri, e në fund të kënaqet me një mësim të

dobët e të papllëshëm, e gjatë kësaj të mendojë se i ka arritur synimet skajore të shkencës!

Gjithashtu drejtpërdrejtë i kemi sprovuar dhe i kemi hulumtuar ato që i publikojnë haptas dhe ato që i fshehin. Përpjekjet e tyre shpihen në atë që ta mashtrojnë botën e thejshtë dhe njerëzit me arsye (logjikë) të dobët, duke shpallur nevojën për mësuesin dhe duke u kundërshtuar, me kuvendime të "fuqishme" dhe "bindëse" me ata të cilët i mohojnë shkaqet e mësimit. E, kur më në fund dikush pranon argumentin e tyre mbi mësuesin e thotë: " Na jepni diturinë e tij dhe na shpërbleni me mësimin e tij!", telamiu do të ndalet e do të thotë: "Tani, pasi që je në pajtim me mua, kërkoje vetë; dëshira ime këtu plotësohet." Sepse, talimiu e di se do të poshtërohej sikur të shkonte më tutje. Ai nuk i lejon vetes t'i afrohet problemeve të caktuara, sepse nuk mundet as ti kuptojë e le më të përgjigjet në to.

Ja se çfarë janë ata në të vërtetë. Kur të njohen mirë, njeriu ua merrë mëri. Atëherë kur i njoftova, i shkunda duart prej tyre.

RRUGËT E SUFISTËVE

Pasi që mbarova me ato shkenca, fillova të interesohem për rrugën e sufistëve. Kuptova se rruga e tyre është e përbërë fuqishëm nga dituria dhe veprimi. Synimi i veprimtarisë së tyre është anulimi i pengesave personale dhe pastrimi i karakterit nga pasionet e këqija dhe cilësitë e shëmtuara, gjersa nuk arrihet që zemra të heq dorë prej gjithëçkaje që nuk është Zoti i Lartmadhërishëm, dhe gjersa zemra nuk stoliset me përmendjen e Zotit.

Mirëpo më lehtë e pata të mesoj se sa të veproj. Fillova t'i mësoja mësimet e tyre nga librat e tyre, siç janë "*Ushqimi i zemrave*" nga Ebu Talib El-Mekije - Zoti e mëshiroftë! -, veprat e Haris Muhasibiut, traditat nga Xhunejdi, Shibliu, dhe Bajazid Bistamiut - Zoti i bekoftë shpirtërat e tyre - dhe veprat e tjera nga shkenca e parisë së tyre, gjersa nuk u njoftova me thelbin e aspiratave të tyre dhe me atë që mundet të arrihet nga rruga e tyre me studime dhe dëgjime. Ndërkaq, mu sqarua se veçantia, për ta më e karakterizuara nuk mund të arrihet me mësim por me ngjërëm (provim, shijim), me përjetimin e gjendjes dhe me ndërrimin e cilësive (vetive).

Sa dallim i madh është ndërmjet asaj që njeriu të dijë përcaktimin e shëndetit dhe ngopshmërisë, shkaqet dhe kushtet e tyre, nga një anë, dhe të jetë i shëndoshë dhe i ngopur, në anën tjetër; të dijë përcaktimin e të dehurit, e kjo shpjegohet me gjendjen e cila pason atëherë kur avullimet nga stomaku mbizotërojnë me burimet e brendshme të mendimit, dhe të jesh i dehur!? I dehuri nuk e di përcaktimin e të dehurit dhe nuk mund ta shpjegojë atë, por ai megjithatë është i dehur edhe pse nuk posedon aspak dijeni shpjeguese për të dehurit. Njeriu i përkorë e di përcaktimin e të dehurit dhe pjesët përbërëse themelore të saj, edhe pse vetë nuk është aspak i dehur. Njeriu i sëmurë e di përcaktimin e shëndetit, shkaqet e tij dhe ilaçet, por - ai është i privuar nga shëndeti.

I këtillë është dallimi ndërmjet asaj që ta njohish esencën e eremizmit, kushtet dhe shkaqet e tij, dhe të jesh në gjendjen e eremizmit dhe vetëmohimit shoqëror nga kjo botë.

Më është bërë krejtësisht e qartë se: sufistët nuk janë aderues të të folurit por janë njerëz të gjendjeve të përjetuara; unë kam nxjerrë atë që mund të nxirret me anë të studimit; ajo që mbetet nuk mund të arrihet me dëgjim dhe me studim, por me përjetim dhe me mënyrën e jetesës.

Duke i falënderuar diturive me të cilat merresha dhe rrugës nëpër të cilën shkoja gjatë gjurmimit të diturive të fesë dhe të diturive të arsyes, arrita gjer tek besimi i patundshëm në Zotin e Lartmadhërishëm, në pejgamberizmin dhe në gjykimin e Fundit. Këto tri parime themelore të fesë u shtypën thellë në shpirtin tim duke i falënderuar shkaqeve, rrethanave dhe eksperiencave të cilat nuk është e mundur të parashtrohen hollësisht, e jo si pasojë e tubimit të zellshëm të argumenteve.

Gjithashtu mu bë e qartë se nuk ka shpresë në fatbardhësinë e përhershme pos në devotshmëri dhe abstenimin personal nga pasionet. Më e rëndësishmja në këtë është të ndërpriten lidhjet e zemrës me këtë botë, shkëputja nga fanitjet e kësaj bote, të drejtuarit vendbanimit të përhershëm dhe kthimi pikës më të lartë të mallëngjimit për Zotin e Lartmadhërishëm. E kjo kërkon të hequrit dorë nga nderimet dhe nga pasuria dhe ikje nga ajo që të kaplon dhe të lidhë.

Pastaj vështrova (shqyrtova) gjendjen time; isha i lidhur me lidhjet e kësaj bote nga të gjitha anët. Iu ktheva veprimtarive të mia, prej të cilave më të mirat ishin ligjërimet dhe mësimet, dhe vëreja se me to isha i lidhur në shkenca të zbrazëta dhe të padobishme për rrugën e përjetësisë. Mendova mirë për shtytjen time në punën

ligjëruese; ajo nuk ishte besnike ndaj Zotit të Lartmadhërishëm, porse nxitjet e dhe iniciatorët e saj ishin kërkimet e nderit dhe namit. U binda me siguri të plotë se qëndroja në buzë të greminës, dhe se, nëse nuk ngritem nga kjo gjendje e rrezikshme, do të përmbyssem në zjarr.

Për këtë mendoja pandërprerë, duke mbetur edhe më tej i pavendosur. Një ditë fuqishëm vendosja ta braktisë Bagdadin dhe ta ndërrojë mënyrën e jetesës së gjertanishme, mirëpo të nesërmen e ndërroja vendimin. Më një këmbë e bëja një çap përpara, por me tjetrën një çap mbrapa. Në mëngjes e ndiesha dëshirën e sinqertë të gjurmoja për përjetësinë, përderisa atë nuk e sulmonte ushtria e të gjitha pasioneve dhe në mbrëmje ngadhënjente. Pasionet e kësaj bote më mbanin të robëruar (farkuar) në vend, kurse ferrëfyeti ka shpallur:

"Në rrugë! Në rrugë! Jeta është e shkurtër, e para teje është rruga e gjatë! E tërë dijenia dhe të bërat që posedon janë vetëm halucinacion dhe shtirje! Nëse që tani nuk je i përgatitur për botën e ardhshme, atëherë kur do të jesh!?"

Dhë atëherë në mua përsëri shfaqej inspirimi dhe vendosmëria e fortë që të ikja dhe të shpëtoja.

Mirëpo, shejtani kthehej përsëri që të më thoshte:

"Ajo gjendje është tepër shumë e rastësishme që t'i dorëzohesh. Ajo do të kalojë shpejt, dhe, nëse i bindesh, do t'i humbish nderimet e mëdha, do ta shkatërrosh jetën e rregulluar mirë me turbullira dhe me mundime, do ta përbysësh siguritetin në

polimizim të lëshimeve. Dhe ndoshta kjo do ta thyejë shpirtin tënd, por këthimi nuk do të jetë i lehtë."

Përafërsisht gjashtë muaj nuk munda të bëja kurrfarë kthese në luftën ndërmjet pasioneve të kësaj bote dhe thirrjes së përjetësisë.

E, kjo ka filluar në muajin rexheb të vitit 488, gjatë të cilit veprimtaria ime kishte kaluar kufirin i cili e ndanë zgjedhjen e lirë nga shtrëngesa. Sepse, Zoti ma kishte lidhur gjuhën dhe më pengonte të ligjëroj. Një ditë, shumë të bukur për zemrat ndryshe të disponuara se çfarë ishte zemra ime, luftoja me ligjërim, por gjuha ime nuk mund ta shqiptonte asnjë fjalë të vetme, dhe assesi nuk mund ta bëja të dëgjueshme. Kjo e lidhur e gjuhës shkaktoi pikëllim në zemrën time, ma rrëmbeu aftësinë e të treturit dhe të marrjes së ushqimit, buka nuk shkonte në fyt, dhu nuk mundja ta bluaj kurrfarë ushqimi. Fuqia më tradhtoi dhe mjekët e patën humbur çdo shpresë në shërimin tim. Ata thoshin: "Sëmundja të ka zbritur në zemër; nuk ka kurrfarë ilaçi, pos të zbulohet fshehtësia e brengës e cila të ka sjellur në këtë gjendje."

Duke ndier pafuqinë time, i paafte të vendosi, mbështetësia në Zotin e Lartmadhërishëm, ashtu siç mbështetet varfanjaku i pafuqishëm. Dhe mu përgjigj ***"Ai, i Cili i vie në ndihmë nevojtarit të ngushtë kur i lutet Atij."*** Ia lehtësoi zemrës sime t'i braktisë nderimet, pasurinë, fëmijët, shokët...

E përhapja vendosmërinë time që të shkoj në Mekke, gjersa, në realitet, në vetvete përgatitesha të shkoj në Siri. Frikësohesha ti tregoja kalifit dhe shokëve të mi qëllimin tim që të vendosem në

Siri. Përdora dinakërinë duke vajtur nga Bagdadi, për shkak të qëllimit që më kurrë të mos kthehesha aty.

Kështu iu nënshtrova qortimeve të të parëve të Irakut, prej të cilëve asnjëri nuk mund ta paramendonte se unë jam në gjendje, për shkaqe të besimit, të braktis atë çka kam qenë në Bagdad, sepse konsideronin se ajo është lartësimi më i madh në Islam. ***"Kjo është arritja e tyre kulminante në dijeni..."***

Pastaj, njerëzit u përzien në supozime; disa jashtë Irakut mendonin se vajtjen time e kishte nxitur pushteti. Ndërsa ata që ishin të afërt me burrshtetasit dhe ishin dëshmitarë të përpjekjeve të tyre që të më ndalin dhe i besnikërisë së tyre, ata të cilët patën parë se kisha refuzuar dhe nuk doja të ndiej për thirrjen e pushtetit, thoshin: "Kjo është goditje nga qielli, shikim i magjiosur i cili, pa kurrfarë arsyeje, i ka goditur myslimanët dhe dijetarët."

Pra, e braktisa Bagdadin duke ndarë më parë pasurinë dhe duke mbajtur për vete vetëm gjërat e domosdoshme për nevojat ditore dhe për ushqimin e fëmijëve. I lejoja këtë vetes, sepse paratë irakiane ishin të dedikuara për të mirat e përbashkëta të myslimanëve, për themelatat mirëbërëse fetare, e unë nuk shihja ndonjë mirësi tjetër më të mirë në botë çfarë do të mund ta bënte dijetari për familjen e vet.

Pastaj vajta në Siri, dhe aty i kalova gati dy vite në tërheqje, në vetmi, në mundime shpirtërore dhe në luftë me vetveten. Isha i okupuar me atë që ta pastrojë shpirtin, ta përsosi karakterin dhe ta stërholloj (rafineroj) zemrën për përmendjen e Zotit të Lartmadhërisëm, ashtu siç pata mësuar nga sufistët. Ca kohë

qëndrova në xhami në Damask, duke kaluar ditë të tëra në minaren e saj, pasi që pas vetit e kyçja derën.

Prej aty vajta në Jerusalem, ku çdo ditë e kaloja në Xhami në shkëmb, gjithashtu duke e kuçyr derën pas veti.

Pastaj, duke përmbushur obligimin fetar, e krewa haxhë në muajin e bekuar në Mekë dhe Medinë, dhe e vizitova varrin e Pejgamberit të Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - dhe pasi që e vizitova varrin e të Dashurit të Zotit - bekimi i Zotit qoftë mbi të! - vajta në Hixhaz.

Diç më vonë, disa obligime dhe thirrjet e fëmijëve të mi më tërhoqën në atdhe dhe unë iu ktheva, ndërsa isha njeriu i fundit që do ta bënte këtë.

Mirëpo, edhe më tej aspiroja të isha vetëm dhe ta pastroja zemrën për përmendjen e Zotit të Lartmadhërishëm. Rrethanat e kohës e shtrembëronin domethënien e dëshirës sime dhe e çrregullonin pastërtinë e vetmisë sime, andaj vetëm kohë pas kohe arrijsha në gjendje përkatëse. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, nuk hiqja dorë nga aspiratat për të, dhe përkundër pengesave arrijsha tek ato (veçimet).

Dhe qëndrova në këtë dhjetë vjet, gjatë të cilave mu zbuluan gjërat, të cilat nuk është e mundur të numërohen e as të tregohen gjër në fund. Ja tani po i parashtroj këto për shkak të dobive prej tyre.

Kuptova me siguritë të plotë se sufistët janë ata të cilët veshëm e pasojnë rrugën e Zotit, dhe se karakteri i tyre është më i virtytshmi. Dhe kur t'u shtohet arsyeja e të arsyeshmëve, mençuria e

të mençurve, dituria e dijetarëv, a do të bëheshin më të mira veprimet dhe karakteri i tyre? Jo, nuk do të bëheshin, sepse në këtë mënyrë do të ndërrohej ajo që ishte e mirë në ta. Çdo dije që është në qetësi dhe që lëvizë në ta, pamja e jashtme dhe brendia e tyre, e tërë kjo ndizet me flakën nga thellësia e pejgamberllëkut. E, përveç dritës së pejgamberllëkut, në faqen e Tokës nuk ndriçon dritë tjetër.

Çka të thuhet për rrugën në të cilën pastrimi përbëhet në pastrimin e zemrës prej çdo gjëje që nuk është Zoti, për rrugën e cila fillon me bashkimin e zemrave në përmendjen e Zotit në vend të kushtrimit me të cilin fillon namazi, për rrugën e cila mbaron në zhdukjen e tërësishme në Zotin. E, ky rezultat, vallë, a nuk është ky fillim në raport me lirinë e zgjidhjes dhe diturisë së fituar? Me të vërtetë, ky është fillimi i rrugës, e ajo që pason është vetëm hajati i saj.

Që nga fillimi i rrugës fillojnë zbulimet dhe të pamit. Në gjendjen e zgjuar sufistët i shohin engjëjt dhe shpirtërat e Pejgamberëve, i dëgjojnë zëret e tyre dhe i përdorin me dobi këshillat e tyre.

Pastaj nga të pamit e fotografive dhe simboleve ngritet gjer tek shkallët për të cilat korniza është tejet e ngushtë për shprehjen, pasqyrimin e diçkaje, kështu që, nëse dikush tenton të shprehë këtë, doemos gabon në deklaratën e vet.

Shkurtimisht, sufistët kështu arrijnë tek afërsia e cila për disa mund të jetë përmbajtje (brendi), për të dytët bashkim, e për të tretët arritje. Mirëpo, të tëra këto mendime janë të gabueshme. Në veprën "*Qëllimi më i lartë*" tanimë e kemi sqaruar natyrën e këtij

gabimi. Atij që nuk e ka përjetuar këtë gjendje duhet vetëm t'i thuhet:

"Çkado që të jetë, këtë nuk do ta them!

Mendo se është e mirë, duke mos kërkuar që të të thuhet.

Me një fjalë, ai i cili kurrë nga kjo nuk ka përjetuar, realitetin e pejgamberllëkut e njeh vetëm për nga emri. E, mrekullitë e njerëzve të shenjtë janë në realitet vetëm paralajmërimet e Pejgamberëve. E kështu ka qenë gjendja e parë e Pejgamberit të Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - kur vajti në malin Hira, që në vetmi të lidhet me Zotin e vet dhe t'i shërbej Atij, dhe kur arabët flisnin: "Muhammedi ndizet nga dëshira e zjarrtë për Zotin."

Këtë gjendje e kërkon ai i cili pason rrugën e sufistëve. E, ai i cili këtë nuk e ka përjetuar vetë, mund të arrijë dijeni origjinare mbi këtë vetëm nga përvoja dhe sjelljeve të buta të sufistëve, nëse shoqërohet me ta aq gjatë përderisa nuk kupton se ajo në parashenjat e veta është e vërtetë. Duke marrë pjesë në ndejt e tyre, mund të nxjerrë dobi nga besimi i tyre, e ata janë njerëz të cilët nuk i sjellin të keqe bashkëbiseduesve të tyre. Ndërkaq, ai i cili nuk ka mundur të shoqërohet me ta, le ta di se ajo është gjë e sigurtë e cila bazohet në dëshmitë e argumentuara, që i kam treguar në kaptinën "*Mrekullitë e zemrës*" të veprës "*Ringjallja e shkencave fetare*".

Shkenca është konstatim i të vërtetës në bazë të argumenteve.

Sprova është lidhshmëria e ngushtë me gjendje të tillë.

Besimi është pranimi i dëshmime gojore dhe i dëshmime të eksperiencave me mendime të mira.

Të këtilla janë këto tri shkallë, e ***"Zoti do t'i ngrisë në shkallë të lartë ata nga mesi i juaj të cilët besojnë dhe të cilët pranojnë dijeni."***

Mbrapa këtyre njerëzve janë injorantët të cilët këtë e mohojnë që nga themeli, i çuditën të folmes së tillë, pastaj përsëri dëgjojnë, tallen dhe thonë: "Çfarë çudie! Si mund të flasin ata kështu!?"

Për të tillët Zoti i Lartmadhërishëm ka thënë:

"Në mes tyre ka (edhe të atillë) që të përgjojnë ty, e posa të largohen prej teje, i pyesin ata të cilëve u është dhënë dijenia: "Ç'tha ai më parë?!" dhe të cilët "i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar sytë."

Në mesin e gjërave të cilat domosdo mu bënë të qarta nga ushtrimi i rrugës së sufistëve ishte vërtetësia e pejgamberizmit dhe partikularizmi i tij. Dhe është e domosdoshme të tërhiqet vërejtja në themelin e tij, sepse kjo është nevojë e madhe e përhershme.

VËRTETËSIA E PEJGAMBERIZMIT DHE NEVOJA E TË GJITHË NJERËZVE PËR TË

Dije se qenësia e njeriut, në krijim e vet burimor nga Zoti, është krijuar e pastër, e thjeshtë dhe pa dijeni mbi cilësitë e Zotit të Lartmadhërishëm. E, ekzistojnë shumë botëra, dhe askush nuk mund t'i numëroj ato përveç Zotit të Lartmadhërishëm, siç është

thënë: *"...Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd..."*

Njeriu e njeh botën përmes vrojtimit, e çdo vrojtim është krijuar që njeriu me anë të tij të kuptojë ndonjë njëmendësi rrojtëse. Me botëra nënkuptojmë krijesa të llojllojshme.

Më së pari që krijohet tek njeriu është shqisa e të prekurit. Me të njeriu vërenë krijesa të llojllojshme, siç janë të nxehtit e të ftohtët, lagështira dhe errësira, njomësia dhe vrazhdësia. Mirëpo shqisës së të prekurit i ikën ngjyrat dhe tingujt; në njëmendësinë e saj ato nuk ekzistojnë.

Pastaj krijohet shqisa e të pamurit. Me të njeriu vërenë ngjyrat dhe format, dhe ajo më së shumti përfshinë botëra të perceptueshme.

Pas kësaj në njeriun krijohet shqisa e të dëgjuarit, me anë të cilës ai dëgjon, i dëgjon tingujt dhe ariet.

Më në fund krijohet shqisa e shijimit.

Dhe kështu ndodhë gjersa njeriu nuk e tejkalon botën perceptuese dhe në të, rreth moshës shtatë vjeç, zhvillohet aftësia e të dalluarit. Kjo është shkalla e dytë e rrojtjes së tij, në të cilën i shquan gjërat të shtuara ndijimeve e të cilat nuk gjenden në botën e shqisave.

Pastaj njeriu arrinë në një shkallë të re. Krijohet arsyeja e tij dhe ai koncepton domosdoshmëritë, mundësitë dhe pamundësitë, dhe gjërat të cilat nuk ekzistojnë në shkallët e mëhershme.

Pas arsyes është shkalla e re në të cilën çilen sy të tjerë. Me to njeriu sheh të fshehtën, dhe atë që do të ndodhë në ardhmëri, dhe

gjëra të tjera të paarritshme për arsyen, sikur që konceptimet e arsyes nuk i janë të arritshme aftësisë së dallueshmërisë, dhe sikur që të arriturat e kësaj fuqie nuk janë të arritura për shqisat e perceptimit.

Po qe se njeriut i cili gjendet në shkallën e dallueshmërisë do t'i prezentoreshin konceptimet e arsyes, ai do ti refuzonte këto, duke i konsideruar si të pamundshme. Po ashtu, disa individ, të cilët gjenden në shkallën e arsyes refuzojnë konceptimet e pejgamberizmit dhe i konsiderojnë ato si të pamundshme. Kjo është injorancë e kulluar, sepse e konsiderojnë si të pabesueshme atë që gjendet në shkallën të cilën nuk e kanë arritur ata. Pasi që nuk është e besueshme për ta, e nuk është e besueshme sepse nuk e kanë arritur atë, ai nuk ekziston edhe në njëmendësi. Po qe se njeriut të verbët, i cili nga transmetimet dhe rrëfimet e të tjerëve nuk ka kuptuar asgjë mbi ngjyrat dhe format, do t'i thuhej për të parën herë diç rreth kësaj, ai këtë nuk do ta kuptonte e as që do ta pranonte.

Zoti i Lartmadhërishëm ua ka lehtësuar krijesave të Veta që ta kuptojnë këtë duke i prirur ata me diçka që është e ngjashme me cilësinë e pejgamberizmit, e kjo është ëndrra. Ëndërrimtari percepton atë të fshehtë që do të ndodhë, qoftë në trajtë të qartë, qoftë në ndonjë trajtë kuptimi i së cilës kuptohet me anë të komentimit. Mirëpo, po qe se njeriut i cili nuk posedon kurrfarë përvoja ëndërruese do t'i thuhet: "Ekzistojnë njerëz të cilët, ngjashëm me të vdekurit, e humbasin vetëdijen, kujtesën, të dëgjuarit dhe të pamurit, dhe të cilët perceptojnë të padukshmën!", ai këtë do ta refuzonte dhe do të tentonte të argumentojë se kjo

është e pamundur, duke thënë: "Aftësitë ndijore janë shkajkorë të perceptimit. Kush nuk i vërenë gjërat në praninë e tyre dhe me ndërmjetësimin e tyre, aq më tepër këtë nuk mund ta bëjë kur ato dobësohen."

Ky është lloj i konkluzionit sipas analogjisë praninë e së cilës e vërteton vetë realiteti dhe dëshmitë njerëzore. Ashtu siç është arsyeja njëra nga shkallët e njeriut në të cilën ekziston, "syri" që "sheh", kuptueshmëritë e llojllojshme të cilat janë jashtë pikëmbërritjes së shqisave, po ashtu edhe pejgamberizmi është përshkrim i shkallës në të cilën gjendet "syri" i prirur me ndriçim në të cilën tregohet e padukshmja dhe bëhen të dukshme gjërat të cilat arsyeja nuk i arrinë.

Dyshimi në pejgamberizëm mund t'i përket vetë mundësisë, ose rrojtes dhe domosdoshmërisë së tij, ose se është serioze në një person të caktuar.

Se pejgamberizmi është i mundur, është argumentuar me atë se ai gjallëron. Gjallërimi i tij është argumentuar me gjallërimin e konceptimeve në botë, të cilat nuk mund të prezentohen si të arritura të arsyes. Ky është rast tek mjekësia dhe astronomia. Ai i cili me siguri është thelluar në to e di se ato janë fituar duke i falënderuar frymëzimit hyjnor dhe me ndihmesën e Zotit të Lartmadhërishëm. Gjer tek ato nuk mund të arrihet me vrojtim. Ekzistojnë ligjet astronomike të cilat bazohen në dukuri gjer të cilat ndodhin një herë në një mijë vjet. Dhe si do të mund të arrihej gjer tek ato me anë të vërojtitimit personal! Po ashtu është edhe me cilësitë e ilaçeve.

Në bazë të këtij argumenti bëhet e qartë se është e mundur të ekzistojë rruga për perceptimin e këtyre gjërave, të cilat arsyeja nuk mund t'i arrijë. Ky është departamenti i pejgamberizmit, edhe pse nuk do të thotë se pejgamberizmi është vetëm prezentim i tij. Perceptimi i asaj që arsyeja nuk mund ta arrijë është një nga cilësitë e pejgamberizmit. Ky posedon edhe shumë cilësi të tjera, e kjo e përmendura është vetëm një pikë uji në det. Këtë e parashtrova sepse ti njeh diç të ngjashme, e kjo është ajo që percepton në ëndërr; posedon gjithashtu dijeni të llojit të këtillë në mjekësi dhe në astronomi, e këto janë mrekullira të Pejgamberëve gjer tek të cilat nuk mund të arrijnë ata të cilët shërbehen me përpjekjet e arsyes.

Cilësitë tjera të pejgamberizmit konceptohen me prova, duke pasuar rrugën e tesavvufit, nëse e ke kuptuar cilësinë e përmendur duke i falënderuar ëndrrës si diç të ngjashme që të është dhënë, e sikur ajo të mos ekzistonte, nuk do të besoshe në këtë cilësi. Sepse, sikur Pejgamberi të posedonte ndonjë cilësi e cila nuk do të ishte assesi e ngjashme me atë që posedon ti, dhe të cilën ti nuk e kupton në esencën e saj, atëherë si do të mund të besosh në të? Besimi vjen pas kuptimit. Në këtë rast duhet të qëndrohet në rrugën e tesavvufit. Një pjesë e kësaj aftësie e mbiarsyes përfitohet me provë, e tjetra me një lloj besimi në atë që i ikën perceptimit sipas përgjasimit, dhe kjo cilësi e thjeshtë e pejgamberizmit atëherë është e mjaftueshme që t'i besohet vetë esencës së pejgamberizmit.

Nëse të paraqitet dyshimi në ndonjë person të caktuar - se a është pejgamber apo nuk është - sigurinë mund ta fitosh duke u

njoftuar, qoftë me anë të bindshmërisë, qoftë me anë të dëgjimit dhe traditës së besueshme, se ç'është ai. Që nga momenti kur të të bëhet e ditur se ç'është mjekësia dhe jurisipodencia, që nga ai moment je në gjendje ta njohësh juristin dhe mjekun, duke u dëshmuar në atë se çka janë ata dhe duke u njoftuar me fjalët e tyre edhe pse ti personalisht nuk i njeh. Dhe kurrë nuk të pengon të konceptosh, dhe atë me konceptim të vërtetë duke mos i pasuar të tjerët, se Shafi'u - Zoti e mëshiroftë - është jurist, e Galeni mjek. Me të vërtetë, mu për shkak se din diç mbi jurisipodencën dhe mjekësinë, dhe për çka, sepse i ke studiuar librat dhe veçoritë e tyre, arrinë gjer tek perceptimi i domosdoshëm mbi atë se çka janë ata në realitet.

Po ashtu, kur të kuptosh domethënien e pejgamberizmit dhe t'i kushtosh shumë kohë depërtimit në Kur'an dhe në Hadith, do të kuptosh me siguritë të plotë se Muhammedi - mëshira dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - qëndron në shkallën më të lartë të pejgamberizmit.

Do të dëshmoresh për këtë hollësisht duke studiuar atë se çka ka thënë ai për veprat hyjnore dhe influencën e tyre në pastrimin e zemrës kur ka thënë të vërtetën: "*Kush punon çka di, Atij Zoti i jep dijeni për atë që nuk di!*", dhe ka pasur të drejtë kur ka thënë: "*Mbi ndihmësin e dhunuesit Zoti i jep pushtet dhunuesit!*", dhe se e vërteta është në fjalët e tij: "*Kush gëdhin vetëm me një brengë, Zoti i Lartmadhërishëm do ta mbrojë nga brengat edhe të kësaj edhe të asaj bote!*" Kur t'i provosh këto fjalë

një mijë herë, dy mijë herë, shumë mijë herë, do të fitosh dijeni të sigurtë në të cilën nuk ka dyshim.

Njëmendësinë e pejgamberizmit kërkoje në këtë mënyrë, e jo në shndërrimin e shkopit në gjarpër dhe në çarjen e Hënës në dysh. Sepse, po qe se këtë ngjarje do ta vështrosh ndaras duke mos i përfillë shumë rrethana të cilat e përcjellin, është e mundur që të mendosh se këto janë akte magjistare dhe fanitje, ose mashtrime nga Zoti, sepse Zoti është Ai i Cili ***"...e shpie në humbje kë të dojë..."***

Në këtë mënyrë për ty do të zgjidhet problemi i mrekullive, e nëse besimi yt është i bazuar në gjykim të besueshëm mbi mënyrën e paraqitjes së mrekullive, atëherë besimi yt do t'i mënjanojë vështirësitë në shqyrtimin e paqartësive të tyre dhe largon dyshimin në to. Shembulli i këtyre dukurive të jashtëzakonshme mund të jetë një nga argumentet dhe momentet në gjykimin tënd të tërësishëm, atëherë kur arrinë ndonjë konceptim të sigurtë, e nuk je në gjendje të përcaktosh themelin e saj konstruktiv. Kjo është sikurse kur një mori njerëzish transmeton një lajm të besueshëm, e nuk është e mundur të emërohet personi në fjalë në të cilin bazohet siguria në autenticitetin e tij. Siguriteti nuk mund të nxirret nga tërësia e zinxhirit të transmetuesve, e as që mund të ndërlihet posaçërisht për dikë, por megjithatë, ky është besim i fortë dhe i ditur.

Eksperienca e drejtpërdrejtë, nga ana tjetër, është sikurse vërojtimi i drejtpërdrejtë dhe kapja me dorë, dhe gjendet vetëm në rrugën e sufistëve.

Kjo që parashtrova mbi vërtetësinë e pejgamberizmit është e mjaftueshme për qëllimin të cilin tani ia caktoj vetes. Dhe do të flas për nevojën për të.

SHKAKU I KTHIMIT PUNËS LIGJËRUESE PAS HEQJES DORË NGA AJO

Më se dhjetë vjet qëndrova në tërhiqje dhe në vetmi. Gjatë kësaj kohe mu sqarua, domosdo dhe duke iu falënderua shkaqeve të cilat nuk është e mundur të parashtrohen gjer në fund, një herë në mënyrë të provës së drejtpërdrejtë, një herë në mënyrë të njohurisë shkencore, një herë në mënyrë të pranimi fetarë, se njeriu është i krijuar nga trupi dhe zemra. Me zemër nënkuptojë njëmendësinë e frymës (intelektit) të tij, e cila është qendër e konceptimit të Zotit, e jo gjaku dhe mishi, të cilat janë të përbashkëta edhe për të vdekurit edhe për coftinat. Dhe mu zbulua se trupi mund të jetë i shëndoshë, ku qëndron fati i tij, dhe mund të jetë i sëmurë, ku qëndron fatkeqësia e tij, e edhe zemra mund të jetë e shëndoshë dhe e qetë - e është i shpëtuar *"vetëm ai i cili vie me zemër të pastër te Allahu..."* - gjersa sëmundja e zemrës është shkatërrimi i tij përgjithmonë. Siç ka thënë i Lartmadhërishmi: *"Zemrat e tyre janë të sëmura..."*

Më tej mu zbulua se mosdija për Zotin është helm shkatërrues, mosbindja ndaj Zotit dhe ndjekja e pasioneve personale është shkak i sëmundjes, ndërsa konceptimi i Zotit është kundërhelm gjallërues, e bindja ndaj Tij dhe kundërshtimi i

pasioneve është ilaç i cili shëron. Dhe kuptova se pa ilaçe nuk ka mënyra që zemra të shërohet, që të zhduken sëmundjet e saj dhe që ajo të bëhet e shëndoshë, sikurse që pa ilaçe nuk është i mundur as shërimi i trupit.

Ilaçet të dedikuara për trup sjellin shërimin e cilësive përkatëse të cilat njerëzit e arsyeshëm nuk i konceptojnë me mundime mendore por domosdo e ndjekin mjekun, të cilët këto dijeni i kanë marrë nga Pejgamberët, e këta, duke i falënderuar cilësisë pejgamberike, i kanë publikuar cilësitë e gjërave. Gjithashtu, në mënyrë të domosdoshme, më është bërë e qartë influenca mjekuese e veprave të devotshmërisë, përcaktimi dhe dimensionit i të cilave vijnë nga Pejgamberët. Influencën e tyre njerëzit e arsyeshëm nuk mund ta arrijnë me mendje, por domosdo duhet t'i ndjekin Pejgamberët, të cilët këto cilësi i kanë arritur nën dritën e pejgamberizmit, e jo duke i falënderuar mendjes.

Ilaçet janë përgatitur nga përbërëset dhe sasirat e llojllojshme, kështu që disa përbërëse janë dy herë më të rënda apo dy herë më shumë, e ky dallim në sasi nuk është pa fshehtësi e cila i takon cilësisë së veçant. Ngjashëm me këtë, edhe veprat e devotshmërisë, të cilat janë ilaç kundër dobësisë së zemrës, janë të përbëra nga veprimet të cilat janë të ndryshme sipas llojit dhe sasisë. Kështu në namaz, pas një përkuljeje vijnë dy lëshime në tokë, e namazi i mëngjesit është sa gjysma e namazit të pasdrekës. Dhe gjithësesi kjo është fshehtësi e madhe e llojit të njëjtë sikurse edhe cilësitë të cilat munden të perceptohen vetëm nën dritën e pejgamberizmit.

Në marrëzi dhe injorancë të madhe bie ai i cili me anë të arsyes dëshiron të tregojë se këto radhitje janë të mençura, ose nëse përfytyron se janë të caktuara me përputhshmëri të rastësishme, e jo që në vete përmbajnë fshehtësinë hyjnore, e cila kërkon mënyrë të veçant, karakteristike vetëm për të, për t'u thelluar në të.

Sikurse që në ilaçe ekzistojnë përbërëset elementare dhe ato plotësuese, të cilat plotësojnë dhe çdonjëra ndikon në influencën e përbërëseve elementare, gjithashtu edhe namazet vullnetare dhe namazet e caktuara me praktikën e të Dërguarit të Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - i plotësojnë aktet themelore fetare për kompletimin e influencës së tyre.

Marrë përgjithësisht, Pejgamberët janë mjekë për shërimin e zemrave. Ndërsa dobia nga arsyeja dhe mundimi i saj i pavarur është ajo që na sqaron dhe që, duke u bindur në vërtetësinë e pejgamberizmit dhe në paaftësinë e vet që ta arrinë atë që vërehet me "syrin" e pejgamberizmit, na kapë për dore dhe na dorëzon udhëheqjes pejgamberike ashtu sikur që të verbërit i dorëzohen udhëheqësve ndërsa të sëmurët e frikësuar mjekëve përdëllimtarë. Këtu është kufiri i arsyes dhe ajo mund të arrijë gjer këtu; arsye është e ndarë nga ajo që gjendet mbrapa, dhe asaj i takon vetëm ta bën të kuptueshëm atë çka mjeku i përshkruan të sëmurit.

Këto janë gjërat të cilat domosdo i konceptova rrjedhim të bindshmërisë së drejtpërdrejtë gjatë viteve të tërheqjes dhe të vetmisë.

Pastaj vërejta se është dobësuar besimi në themelin e pejgamberizmit, në vërtetësinë e pejgamberizmit dhe në sjelljen

sipas normave siç i ka sqaruar pejgamberizmi. U binda në zgjerueshmërinë e kësaj në mesin njerëzve dhe i vëzhgova shkaqet e dobësisë njerëzore dhe dobësimit të besimit të tyre. Gjeta se ekzistojnë katër lloj njerëzish përgjegjës për këtë gjendje:

1. ata që i janë lëshuar (dorëzuar) filozofisë;
2. ata që i janë lëshuar tesavvufit;
3. ata që kanë pranuar thirrjen mbi të mësuarit;
4. veprimet e atyre të cilët në sytë e njerëzve shquhen me dijeni.

Një kohë i përcillja disa njerëz, e studioja atë që nuk i mbahej ligjit fetar dhe dyshimin e tij, dhe polemizojë për besimin e tij dhe për mendimin intim të tij. I thosha atij: "Përse nuk je konsekuent? Nëse i beson botës së ardhshme, e nuk përgatitesh për të, por e ndërron atë me këtë botë kaluese, kjo është marrëzi! Nëse tanimë nuk i ndërron dy për një, si mund ta ndërrosh jetën e amshueshme me ditë të numëruara? Nëse megjithatë nuk beson në të, atëherë ti je pabesimtar, dhe kthehu kah kërkimi i besimit, shqyrtoje se çka është shkaku i mosbesimit tënd të fshehtë, e ky është drejtimi yt i brendshëm dhe shkaku i prepotencës sate të jashtme, edhe pse ti me të nuk pajtohesh, ke mendim të mirë për fenë dhe shprehë respekt ndaj ligjit fetar."

Njëri do të përgjigjej: "Nëse do të duhej që domosdo t'i përmbahemi kësaj, atëherë dijetarët janë të parët të cilët duhet të japin shembull të tillë. Mirëpo, njëri më i njohur nga mesi i të njohurve nuk e kryen namazin, i dyti pin verë, i tretë shpenzon pasurinë e themelatave mirëbërëse fetare dhe të bonjakëve, i katërti

merr nga arka e shtetit dhe nuk ngurron nga gjërat e ndaluara, i pesti pranon mito për gjykim dhe për dëshmi. E kështu me radhë, dhe të ngjashme me këtë!"

I dyti do të konfirmonte se aq shumë ka përparuar në shkencën e tesavvufit, sa që gjendet në atë shkallë ku nuk nevojiten aktet e devocionit.

I treti do të arsyetohej me dyshimin e huaj, respektivisht me dyshimin e pasuesve të drejtimit ibahije, e ata që të gjitha kanë devijuar nga tesavvufi.

I katërti, i cili është shoqëruar me talimijet, do të thoshte: "E vërteta është kontestuese. Rruga gjer tek ajo është e vështirë. Kurrnjë drejtim nuk ka përparësi ndaj tjetrit. Argumentet e arsyes janë kontradiktore. Nuk mund t'u besohet mendimeve të mendimtarëve spekulativ. Ndërsa pasuesit e të mësuarit gjykojnë pa pasur nevojë për argument. Në këto kushte, si të mos dyshohet në njëmendshmëri!?"

I pesti thotë: "Qëndrimi im nuk është të imituarit. Përkundrazi, unë kam studiuar filozofinë dhe e kam konceptuar vërtetësinë e pejgamberizmit. Kam kuptuar se serioziteti i tij i kthen njerëzit kah urtësia dhe vlera, dhe se synimi i besimit në pejgamberizëm është ta disiplinojë masën e gjerë dhe t'i pengojë njerëzit të mbyten ndërmjet veti, që të mos grinden dhe të mos u lëshohen pasioneve. E unë nuk jam njëri nga ata injorantë të thjeshtë e që të duhej t'i nënshtrohesh obligimeve të caktuara. Unë jam nga mesi i njerëzve të mençur dhe duke i falënderuar kësaj shoh qartë dhe nuk kam nevojë t'i pasoj të tjerët."

Ky është kulminacion i besimit të atij që ka studiuar doktrinën filozofike të metafizikanëve dhe ka studiuar mbi këtë me libra të ibën Sinit dhe Ebu Nasër Farabiu. Këta njerëz dobësinë e vet e fshehin me Islam.

Ndoshta do ta shohësh dikë prej tyre duke mësuar Kur'anin, merr pjesë në tubimet fetare dhe në namaze, e madhëron me fjalë ligjin fetar, e njëkohësisht pinë pandërpre, pastaj mëkaton dhe vepron keq edhe në mënyra të tjera. Dhe kur i thuhet atij: "Përse e kryen namazin nëse pejgamberizmi nuk është i besueshëm?". ndoshta do të përgjigjej: "Që ta ruaj shëndetin trupor, t'i mbaj zakonet lokale, ta siguroj pasurinë dhe fëmijët." E ndoshta do të thoshte: "Ligji fetar është autentik, e pejgamberizmi është i vërtetë." E kur t'i tërhiqet vërejtja: "Përse atëherë pinë verë?", do të përgjigjet: "Vera është e ndaluar për shkak se nxitë dhunën dhe urrejtjen, e unë, duke i falënderuar mençurisë sime, jam i mbrojtur nga kjo. Duke pirë, vetëm dëshiroj ta nxisë frymën time. Ndërkaq ibën Sina në testamentin e vet ka shkruar se i është zotuar Zotit të Lartmadhërishëm, përveç tjerash, se do t'i madhëron dispozitat e ligjit fetar dhe do t'i shprehë obligimet religjioze dhe se nuk do të pinë verë nga dëshira por vetëm për shkak të mjekimit dhe shërimit. E gjendja e tij më e lartë ka qenë në pastërtinë e fesë dhe në kryerjen e obligimeve religjioze, nëse nuk merret parasysh pirja e verës."

I këtillë është besimi i filozofëve të cilët e rrëfejnë fenë, dhe këta shumëkëndin e kanë mashtruar. E mashtrimi ka qenë edhe më i madh për shkak të dobësisë së vërejtjeve të atyre që u janë

kundërvuar, sepse u janë kundërvuar duke kundërshtuar gjeometrinë, logjikën dhe shkencat e tjera të tyre, siç thamë edhe më parë, të cilat nga pikëpamja e arsyes janë domosdo të vërteta.

Duke i njohur llojet e njerëzve besimi i të cilëve është dobësuar nga shkaqet e përmendura, pash se detyra ime është që ta tregoj sheshit këtë lajthitje. E, të tregoj se çfarë janë ata njerëz në të vërtetë, për mua ishte më lehtë se sa ta pija një gëllënkë ujë, sepse shumë herë i kam shoshitur shkencat e tyre dhe rrugët e tyre - mendoj në rrugët e "sufistëve", "filozofëve", "talimijëve", dhe "dijetarëve të shquar". Më është bërë e qartë se ky është obligim i pashtyeshëm në këtë kohë. Çfarë thesari është në tërhiqje dhe në veçim pasi që sëmundja është gjithpërfshirëse (e gjithmbarshme), mjekët të sëmurë e njerëzit më autoritativ janë duke u shkatërruar!?

Pastaj i thash vetes: "Kur do të vëshesh në shpërndarjen e kësaj errësire dhe në zhdukjen e këtij terri, gjersa është koha e dobësirave dhe periudha e pavërtetësisë!? Po qe se lëshohesh në atë që njerëzit t'i largosh nga rrugët e tyre dhe t'i thërrasish kah e vërteta, të gjithë bashkëkohësit do të kthehen kundër teje. Po qe se u kundërvihesh, si do të mund të jetosh me ta? Kjo është e mundur vetëm në një kohë të volitshme dhe me ndihmën e sunduesit të devotshëm dhe të paluhatshëm."

Dhe besoja se Zoti i Lartmadhërishëm më lejonte të qëndroja në vetmi, për shkak se isha i pafuqishëm ta publikoj të vërtetën duke e argumentuar atë. Mirëpo, Zoti i Lartmadhërishëm e nxiti sunduesin e atëhershëm që ai vetë dhe pa kurrfarë ndikimesh nga jashtë të më urdhërojë të shkojë në Nishapur për ta eliminuar

këtë turbullirë. Urdhëri ishte aq i rreptë, sa që më kërcënohej ndëshikimi i rëndë po qe se do ta shtyeja zbatimin e tij.

Dhe më ra ndër mend se arsyetimi im për veçim tani ishte dobësuar, andaj i thash vetes: "Nuk është e drejtë që shtytja yte për tërhiqje të jetë dembelia apo prirja për të pushuar, kërkim i namit personal apo ruajtja nga telashet njerëzore. Sepse ti vetvetes nuk i ke dhënë leje nga shkaku se e ke pasur vështirë."

Zoti i Lartmadhërishëm thotë:

"Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Elif, Lam, Mim. A mendojnë njerëzit se do të lihen të qetë nëse thonë: "Ne besojmë" e që ata nuk do të vihen në sprovë? E Ne i kemi sjellë në sprovë edhe ata që kanë qenë para tyre, që Allahu me siguri të tregojë për ata që thonë të vërtetën dhe për ata që gënjejnë."

Dhe i Plotfuqishmi, i Lartmadhërishmi i thotë Pejgamberit të Vet, e ai është më i denji në mesin e krijesave të Tij:

"Edhe para teje (o Muhammed) Pejgamberët kanë qenë të përgënjeshtroar, e ata vuanin për atë që i përgënjeshtrojnë dhe që i mundonin përderisa nuk u vinte ndihma Jonë, - e askush nuk mund t'i ndryshojë fjalët e Allahut -, dhe, padyshim, te ti kanë arritur disa lajme për Pejgamberët."

Dhe i Gjithëfuqishmi, Shumë i Larti:

"Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Ja Sin. Pasha Kur'anin plotë urtësi, ti (o Muhammed) me të vërtetë je Pejgamber, në rrugën e drejtë, me shpalljen e Plotfuqishmit, Mëshirëplotit, që ta paralajmërosh popullin -

paraardhësit e të cilit nuk ishin të paralajmëruar, prandaj (ata) kanë qenë indiferent! Me të vërtetë u realizua Fjala ndaj shumicës së tyre - e ata nuk besojnë. Ne kemi bërë që të jenë sikurse ata të cilëve u kemi vënë pranga (zinxhirë) në qafë, e ato u arrijnë deri nën mjekër, - andaj ata janë me kokë përprjetë, dhe sikurse ata përpara të cilëve dhe mbrapa të cilëve kemi vënë parmak - andaj ata nuk shohin. Dhe për ata është njësoj i paralajmërove ti ose nuk i paralajmërove, ata nuk do të besojnë. Paralajmërimi yt do t'i sjellë dobi vetëm atij që ndjek Kur'anin..."

Përkitazi me këtë u këshillova me shumë njerëz të udhëzuar në shkencat e zemrës dhe me eksperiencë të drejtpërdrejtë, dhe të gjithë më porositën ta braktis veçimin (vetminë) dhe të dalë nga mbështjellësi. Krahës kësaj, edhe shumë njerëz tjerë të mirë kanë pasur ëndërrime të besueshme të cilat dëshmonin se vendimi i tillë, me përcaktimin e Zotit të Lartmadhërishëm, është fillimi i të mirës dhe këndellje në fillim të këtij shekulli. Sepse, Zoti i Lartmadhërishëm ka premtuar se do ta ringjallë fenë e Vetë në fillim të çdo shekulli.

Duke i falënderuar këtyre dëshmive, shpresa ime u forcua dhe mbizotëroi mendimi i mirë. Zoti i Lartmadhërishëm ma lehtësoi të marrë vendimin për pranimin e detyrës në Nishapur në muajin dhul-kade të vitit 499. Duke qenë se nga Bagdadi pata vajtur në dhul-kade të vitit 488, rrjedh se veçimi im ka zgjatur plotë njëmbëdhjetë vjet.

Ky vendim është përcaktim i Zotit të Lartmadhërishëm, njëri nga përcaktimet e Tij misterioze, në të cilën nuk kam ardhur me anë të zemrës gjatë tërheqjes sime, sikurse që edhe nuk kam vendosur vetvetiu që të shkoj nga Bagdadi dhe ta braktis vendin tim të atëhershëm. Zoti i Lartmadhërishëm është Ai i Cili i ndryshon zemrat dhe gjendjet, e *"Zemra e besimtarit është ndërmjet dy gishtërinjve të Zotit Mëshirëplotë."*

Tani e di mirë: po qe se do t'i kthehesha mësimëdhënies, në realitet, ky nuk do të ishte kthim. Kthimi është kthim i asaj që ka qenë, e në kohën kur jepsha mësim, unë e përhapja doktrinën me të cilën përfitohej nami. Dhe thirrja në të edhe me fjalë edhe me vepër. I tillë ishte synimi im dhe qëllimi im. Tani unë thërras kah shkenca me ndihmën e së cilës lihen namet dhe konceptohet parëndësia e tyre.

Ky është synimi dhe qëllimi im i tanishëm, dhe Zoti e di se është ashtu. Dëshiroj që veten dhe të tjerët t'i bëjë më të mirë, por nuk e di se a do të më plotësohet dëshira apo do ta përfundojë jetën duke mos e arritur qëllimin tim. Megjithatë besoj me besim të sigurt, të bazuar në argumentim, se *"nuk ka fuqi as forcë pos tek Zoti i Plotfuqishëm dhe i Lartmadhërishëm"*, se unë nuk lëviz, por Ai më lëvizë, se unë nuk veproj, por Ai vepron me mua. Dhe e lus At që së pari mua të më bëjë më të mirë e pastaj me ndihmën time ti përmirësojë të tjerët, që mua të më udhëheqë e pastaj të më bëjë udhërrëfyes të të tjerëve, që të vërtetën të ma bëjë me të vërtetë të dukshme dhe të më shpërblejë që ta pasojë atë, që të ma tregojë lajthitjen dhe të më mundësojë ti iki asaj!

Tani do t'i kthehemi shkaqeve të dobësimit të besimit, duke akcentuar mënyrën se si njerëzit të udhëhiqen rrugës së drejtë dhe të shpëtohen nga shkatërrimi.

Për sa u përket atyre të cilët shkaktojnë turbullira për shkak të asaj që kanë dëgjuar nga talimijet, ilaçi për ta gjendet në librin tonë "*Kriteri i drejtë*", dhe mbi këtë nuk është nevoja të flasim më gjerë në këtë letër.

Për sa u përket atyre të cilët janë zhgënjyer me mashtrimet e ibahijeve, lajthitjet e tyre i kemi klasifikuar në shtatë grupe dhe i kemi zbuluar në veprën "*Alkimia e lumturisë*"

Për sa u përket atyre besimi i të cilëve, duke qenë se kanë ndjekur filozofinë, është turbulluar gjer në ato përmasa sa që mohojnë madje edhe vetë themelin e pejgamberizmit, tanimë kemi folur për njëmendësinë e pejgamberizmit dhe rrojtjen e tij të domosdoshme, duke argumentuar këtë me rrojtjen e shkencës mbi cilësitë e ilaçeve, yjeve etj. Këtë studim paraprak e kemi renditur mu për këtë shkak. Jemi shërbyer me argumentin nga cilësitë e veçanta të mjekësisë dhe astronomisë, sepse ai është karakteristikë e vetë esencës së këtyre shkencave. Mirëpo, me shkathtësinë e shkencave, siç janë astronomia, mjekësia, shkencat natyrore, magjia, parashikimi i fatit, çdo shkencëtar mund t'ia sqarojmë argumentin e pejgamberizmit me shembull nga vetë shkenca e tij.

Ai i cili megjithatë vetëm me fjalë pranon pejgamberizmin dhe i barazon dispozitat e ligjit fetar me mençurinë, ai, në realitet, seriozisht mohon pejgamberizmin. Ai i beson vetëm çfarëdo urtaku

të lindur nën shenjën e ndonjë ylli i cili cakton që ta pasojë atë. E këtu nuk ka asgjë nga pejgamberizmi.

Përkundrazi, besimi në pejgamberizëm është pranimi i njëmendësisë të një niveli mbikuptimor në të cilin hapet syri me të cilin vërehet diç e posaçme ndaj së cilës arsyeja është e pafuqishme ashtu sikurse që shqisa e të dëgjuarit është e pafuqishme për vërejtjen e ngjyrave, të pamurit për vërejtjen e tingujve, e të gjitha shqisat për vërejtjen e gjërave që i përkasin mendjes.

E, po qe se ai nuk lejon këtë, ne parashtruam argumentin se ai nivel, jo vetëm që është i mundur, por se ai me të vërtetë ekziston. E nëse lejon këtë, atëherë pranon se këtu ekzistojnë gjëra të cilat quhen të veçanta dhe të cilat arsyeja, për shkak se nuk është në gjendje t'i përfshijë këto në themelin e tyre, i shpallë të rrejshme dhe gjykon se këto janë marrëzira.

Një e gjashta e draimit të opiumit është helm vdekjeprurës, sepse për shkak të ftohtësisë së jashtëzakonshme të tij e ngrinë gjakun në damarë. Për atë i cili i përmbahet shkencave natyrore, çdo trup i përbërë bëhet i ftohtë për shkak se është i përbërë nga uji dhe dhéu si elemente të ftohta. Ndërkaq është e njohur se ritla të tëra të ujit dhe të dhéut nuk mund të nxisin në trup ftohtësirë të tillë. Po qe se i tregojmë këtë natyralistit, i cili këtë nuk e ka provuar drejtpërdrejtë, do të thoshte: "Kjo është e pamundur, e dëshmia e pamundësisë qëndron në atë se opiumi përmbanë zjarrë dhe ajër, pra, elemente të cilat assesi nuk mund ta rrisin ftohtësirën. Aq më tepër, sikur të supozonim se çdo gjë është vetëm ujë e dhé, as atëherë nuk do të mund të paraqitej ftohtësirë aq e madhe.

Atëherë si është e mundur që gjer tek kjo të sjellin dy elemente të ngrohta?" Dhe këtë do ta konsideronte si argument.

Shumë argumente filozofike në shkencat natyrore dhe në metafizikë i takojnë këtij lloji. Filozofët i paraqesin gjërat sipas masës së zbulimeve dhe kuptimeve të veta, e atë që me to nuk mund të pajtohen e konsiderojnë si të pakuptimtë.

Sikur ëndrra e vërtetë të mos ishte aq e zakonshme, e sikur ndokush do të konfirmonte se e fshehta i zbulohet gjersa shqisat i janë të qeta, njerëzit me arsye të tillë sigurisht do ta mohonin këtë.

Dhe sikur ti thuhej ndonjërit prej tyre: "A është e mundur që në këtë botë të ekzistojë një send me madhësi të kokrrës, i cili, i lënë në ndonjë qytet, do ta gëlltiste tërë atë qytet dhe pastaj do ta hante vetveten, e që të mos mbetet asgjë as nga qyteti as nga ajo që gjendet në të e as nga vetvetja e tij?", ai do të thoshte: "Kjo është e pamundur, kjo është një mori fjalësh të pakuptimta!" E i këtillë është rasti me zjarrin, edhe pse këtë e mohon ai i cili nuk e ka parë kurrë zjarrin kur ka dëgjuar për të.

Shumë mohime të mrekullive të botës së ardhshme i gjasojnë mohimeve të këtilla.

Prandaj do t'i themi natyralistit: "Ishe i detyruar të pranosh se si opiumi posedon veçantinë e ftohtësirës, edhe pse kjo nuk pajtohet me njohuritë mendore mbi natyrën. Përse atëherë mos të jetë e mundur që dispozitat e ligjit të fesë të mos kenë cilësi të shërimit dhe të pastrimit të zemrës, cilësi të cilat nuk mund të konceptohen me urtësinë e arsyes e as që përgjithësisht mund vërehen, pos me syrin e pejgamberizmit?"

Aq më tepër, ata në librat e tyre lejojnë cilësi edhe më të çuditshme. E njëra nga cilësitë e tilla të çuditshme është edhe procedimi i ndihmesës së gruas shtatzënë e cila ka vështirësira gjatë lindjes. në dy copa pëlhure, të lagura me ujë, shkruhet sa vijon:

DAL	TA	BA
XHIM	HA	ZAL
HA	ELIF	VAV

4	9	2
3	5	7
8	1	6

Lehona e ngulë shikimin në to, i vënë ato nën këmbë, dhe foshnja nxiton së daluri. Ata këtë e pranojnë si të mundshme në librin "*Cilësitë e mrekullueshme*". Ky vizatim i ka nëntë katrorë ku gjenden numrat gjegjëse shumat e të cilëve në çdo rend, është pesëmbëdhjetë, edhe nëse mbledhen horizontalisht, vertikalisht apo pjertazi.

Do të dëshiroja të dija se kush mund të besojë në këtë, e që pastaj mendjen e vet të mos e përgatitë të pranojë se në atë që namazi i mëngjesit i ka dy, i pasdrekes katër dhe i mbrëmjes tri përkulje, gjenden cilësitë të cilat nuk mund të kuptohen me përsiatjet filozofike. Shkaku i kësaj është ndryshueshmëria e kohës së ditës, e këto cilësi konceptohen me ndihmën e dritës së pejgamberizmit.

Mirëpo, është gjë e çuditshme; sikur ta ndryshonim mënyrën e komentimit e të shpreheshim në gjuhën e astrologut, ata do ta kuptonin ndryshueshmërinë e kohës së ditës. Mund të themi për shembull: A nuk ndodh që horoskopi të ndërron sipas asaj që Dielli

gjendet në mes të qiellit, në lindje ose në perëndim!? A mos vallë në horoskopet e tyre ata nuk i marrin këto ndryshime si bazë për terapi të llojllojshme apo për zgjatjen e jetës dhe çastin e vdekjes!? E nuk ka kurrfarë dallimi në atë se a është Dielli i fshehur apo është në zenit, a ka lindur apo është duke perënduar! Atëherë a ekziston mundësia që dikush prej tyre të besojë në këtë, e që këtë të mos e ketë dëgjuar nga komentimi i astrologut, madje edhe nga ai i cili shumë herë e ka mashtruar, dhe të cilit ai gjithashtu nuk i beson përderisa astrologu mu atij nuk i thotë: "Kur Dielli të jetë në qendër të qiellit dhe në të do të shikojë ai dhe ai yll, ndërsa horoskopi yt është nën shenjën e këtij dhe këtij hyllësie, dhe ti në atë çast i vesh rrobat e reja, do të jesh i vrarë mu në ato roba!" Ai me siguri nuk do t'i veshë ato rroba në atë moment, edhe nëse pëson nga të ftohtët, edhe pse këtë e ka dëgjuar nga astrologu për të cilin e di se tanimë e ka mashtruar shumë herë.

Do të dëshiroja të dija se kush mundet ta bënë arsyen e vet të gatitur që t'i pranojë këto gjera ekstravagante, dhe ta detyrojë atë që t'i konceptojë ato si cilësi konceptimi i të cilave, në realitet, është aftësia e mrekullueshme e Pejgamberëve; si mundet, pra, ai njeri të mohojë diç të ngjashme që dëgjon nga rrëfimi i Pejgamberit, kryesit të vërtetë të mrekullirave për të cilin e di se kurrë nuk ka gënjyer?

Nëse filozofi mohon mundësinë e këtyre cilësive në numrin e pjesëve përbërëse të namazit, gjuajtjen e guralecëve, numrin e pjesëve përbërëse të ceremonisë së haxhxit dhe të obligimeve të tjera fetare, ai nuk do të gjejë kurrfarë dallimesh esenciale ndërmjet tyre dhe cilësive të ilaçeve dhe të yjeve.

Ai mund të thotë: "Kam ngapak përvojë në gjërat e astronomisë dhe të mjekësisë, dhe për disa elemente të shkencës kam konstatuar se janë të vërteta. Andaj besimi për to në mua është përforcuar dhe zemra ime ka humbur çdo prirje për t'iu shmangur dhe të shikojë në to me mosbesim. Pejgamberizmin nuk e kam shijuar, e si ta dijë unë se ai ekziston dhe si të besoj se ai është i vërtetë?" Nëse pranoj se kjo është e mundur, do të them: "Ti, në të vërtetë, nuk kundërshton të besosh në atë që nuk e ke shijuar, sepse ti këtë e ke dëgjuar nga njerëzit të cilët e kanë shijuar këtë, e ti i pason ata. Andaj dëgjoji fjalët e Pejgamberëve! Ata kanë shijuar dhe janë bindur në vërtetësinë e të gjithave që shpallë ligji fetar. Pasoje rrugën e tyre, e edhe vet do të bindesh në diç prej tërë kësaj!"

Krahas kësaj them: "Madje edhe nëse nuk e shijon këtë, arsyeja e jote gjykon se në këtë domosdo duhet të besohet dhe se domosdo duhet të pasohet. Të supozojmë se ekziston ndonjë njeri, i rritur dhe i arsyeshëm, i cili nuk e ka shijuar sëmundjen dhe i cili sëmuret. Të supozojmë se ai ka babain, njohës të kujdesshëm dhe përdëllimtar të mjekësisë, e që për njohjen e tij në mjekësi ai ka dëgjuar që nga fëmijëria. Babai ia përgatitë ilaçin dhe i thotë: "Ky është i mirë për ty dhe do të të shërojë nga sëmundja". Çka do të kërkonte atëherë arsyeja e tij nga ai, madje edhe nëse ilaçi është i hidhët dhe i pashijshëm? - Ta merr, apo ta refuzojë, e të thotë: "Unë nuk e kuptoj mjekësinë e këtij ilaçi, ende kurrë nuk e kam shijuar! Pa dyshim, sikur ai të vepronte kështu, ti do ta konsideroshe atë të

marrë. E mu ashtu i marrë dukesh edhe ti për shkak mosbesimit tënd në sytë e njerëzve të cilët shohin qartë."

Nëse thua: "Si ta konceptoj kujdesin, përdëllimin dhe dijeninë e Pejgamberit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - duke i falënderuar këtë shembull nga mjekësia?", do të përgjigjem: "Si e ke konceptuar kujdesin dhe përdëllimin e babait tënd, duke qenë se kjo nuk është send i shqisave!? E ke konceptuar duke i ditur rrethanat e jetës së tij dhe duke u bindur në tërësinë e veprimtarisë së tij, dhe atë me dijeninë e domosdoshme dhe të pamohueshme."

Ai i cili i ka studiuar fjalët e Pejgamberit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! - dhe atë që prezantohet në tradita mbi kujdesin e tij që t'i udhëzojë njerëzit, butësinë e tij në udhëheqjen e njerëzve, të shprehur në veprime të shumëllojshme e të buta, ndieshmërinë me të cilën e mirësonte karakterin e tyre dhe i përmirësonte marrëdhëniet e tyre, dhe përgjithësisht të tërë atë që e bënë më të mirë religjionin e tyre dhe jetën e tyre në këtë botë, ai njeri domosdo do të konceptojë se kujdesi i të Dërguarit të Zotit ndaj ithtarëve të vet është më i madh se kujdesi i prindit ndaj fëmijës së vet.

Atëherë kur po ky njeri i shqyrton veprat e mrekullueshme, të cilat janë zbuluar në rastin e tij, mrekullitë e padukshmës të cilat përmes gojës së tij janë njëmendësuar në Kur'an dhe në Hadith, pastaj rrëfimet e tij mbi Ditën e fundit, së bashku me përmbushjen e atyre parashikimeve, atëherë ai domosdo do ta kuptojë se i Dërguari i Zotit ka arritur nivelin përmbi arsyen, në të cilin atij iu është çelur syri me ndihmën e të cilit zbulohet e padukshmja, e që është e

arritshme vetëm për njerëzit e zgjedhur, dhe konceptimin e gjërave të paarritshme për arsyen. Me këtë arrihet dijenia e domosdoshme mbi sinqeritetin e të Dërguarit të Zotit - bekimi dhe paqja e Zotit qofshin mbi të! Andaj përpiqu! Përsiate Kur'anin dhe studioje Hadithin, dhe kjo do të të bëhet tërësisht e qartë!

Ky është sinjalizim i mjaftueshëm për të gjithë ithtarët e filozofimit. E parashtrova këtu duke konsideruar se kjo është posaçërisht e nevojshme në këtë kohë.

Përsa i përket shkakut të katërt të dobësimit të besimit, e kjo është mënyra e keqe e jetesës së dijetarëve, shërimi nga kjo sëmundje kërkon tri gjëra:

E para është se duhet t'i thuash vetes se dijetari i fesë, për të cilin konsideron se e hanë të ndaluarën, e din se është e ndaluar vera, mishi i derrit, kamata, aq më tepër, se është e ndaluar përgojimi, rrena, shpifja. Edhe ti vetë e din këtë, e megjithatë e bënë këtë, jo pse nuk beson se kjo është mëkat, por për atë se pasioni të ka ngadhënjyer. E pasioni i dijetarit të fesë është sikurse pasioni yt, e ka ngadhënjyer atë njësoj sikurse edhe ty. Fakti se ai di edhe gjëra të tjera pos kësaj, e dallon nga ti, por kjo nuk do të thotë se ai duhet më tepër të përmbahet nga veprat e ndaluara. Shumë njerëz të cilët besojnë në mjekësi nuk mund të ndalen nga ngrënia e pemëve dhe nga pirja e ujit të ftohtë, edhe pse këtë ua ka ndaluar mjeku. Dhe askush nuk argumenton se kjo nuk është e dëmshme, ose që besimi në mjekësi nuk është i vyeshëm. Mëkatimi i dijetarëve të fesë nuk ka shkak tjetër.

Gjëja e dytë është t'i thuhet njeriut të rëndomtë: "Duhet ta dish se dijetari i fesë e merr dijeninë e vet sikurse thesar për botën e ardhshme, dhe mendon se dijenia e vet do ta shpëtojë dhe se do t'i bëhet ndihmës, aq më tepër, se për shkak të vlerës së diturisë së vet do të jetë i ndërmjetësuar për veprat e këqija të tij. E, nëse dijenia e vet mund të jetë dëshmi më tepër kundër tij, ajo gjithashtu mund ta ngrit në nivel më të lartë. Kjo është e mundur, dhe ai, po qe se i lë pas dore veprat e veta, do të thirret në dijeni. E çka do të bësh ti si njeri i thjeshtë, nëse e merr shembull atë, e i lë pas dore veprat tuaja, e nuk posedon dijeni!? Do të pësosh për shkak të veprimeve të këqija, e për ty nuk do të ndërmjetësohet."

Gjëja e tretë, e kjo është e vërtetë, se dijetari i vërtetë i fesë gabon vetëm nga pakujdesia; ai assesi nuk ngulmon në mëkat, sepse dituria e vërtetë është ajo e cila na mëson se mëkati është helm i cili shkatërron, dhe se ajo botë është më e mirë se kjo botë. E, ai i cili e kupton këtë, ai nuk e shet të mirën për diç më pak të vlefshme. Gjer tek kjo dituri nuk arrihet me asnjë nga ato shkenca me të cilat mirren shumica e njerëzve. Prandaj këta njerëz dijenia e tyre i bënë edhe me të guximshëm kur gabojnë ndaj Zotit të Lartmadhërishëm.

Për sa i përket diturisë së vërtetë, tek ai i cili e posedon këtë, ajo ia rritë drojën, frikërrespektin dhe shpresën, e kjo vëhet ndërmjet tij dhe mëkatit, pos në momentet e moskujdesit, të cilave njeriu kohë pas kohe, nuk mund t'u ikë. Mirëpo, kjo nuk udhëzon në dobësimin e besimit. Besimtari, kur gabon, pendohet. Larg asaj që ai në këtë të ngulmojë apo ta madhërojë këtë.

Ja, këtë desha ta paraqes si gjykim të filozofëve dhe talimijëve, mbi dëmin i cili vjenë nga ata dhe mbi dëmin i cili vjenë nga ata të cilët i kundërshtojnë në mënyrë të gabuar.

E lus Zotin e Lartmadhërishëm të na rendis në mesin e atyre të cilët i janë të dashur dhe të cilët Ai i ka dekoruar, të cilët shpien kah e vërteta, dhe të cilët i udhëzon dhe i frymëzon që ta thërrasin Atë gjithnjë derisa nuk mund ta harrojnë kurrë më, të cilët i mbronë nga e keqja në vetveten e tyre derisa nuk u bëhet kurrigjë më e dashur se Ai, të cilët i shpëton në vetveten e tyre derisa nuk mund ta adhurojnë askë tjetër përveç Tij!

PRANË KËTIJ PËRKTHIMI

Përkthimi i veprës "Shpëtim nga lajthitja është bërë sipas botimeve të origjinalit të cilat i kanë mbarështuar Mustafa Ebul-Ula dhe Muhammed Xhabir (El-munkiz min ed-dalal, Kajro, 1973) dhe Abdul-Halim Mahmud (El-munkiz min ed-dalal, Bejrut, 1979). Për vendet kontestuese është bërë barazimi i sërishëm me tekstin e origjinalit në redaksinë e Xhemil Salibit dhe Kamil Ijadit (botimet: Xhemil Salib dhe Kamil Ijad, El-munkiz min ed-dalal, Bejrut, 1983, Ferid Xheber, El-munkiz min ed-dalal, origjinali arab dhe përkthimi frëng, Bejrut, 1969). Është përdor përkthimi rus i A. V. Sagadejevit (në librin: S. N. Grigorijan, Iz istorii filozofii Srednej Azii i Irana /VII-XII vv., Moskva, 1960) dhe përkthimi anglez i W. Montgomery Wattit (The Faith and Practice of Al-Gazali, Lahor, 1963).

